

27.01.2021

z. Izet Rushiti,
U.d. Kryesues i Bordit të ZRrE
Zyra e Rregullatorit për Energji

Azhurnimet vjetore për tarifat e KOSTT që pritet të hyjnë në fuqi më 1 Prill 2021

I nderuar z. Rushiti,

Bazuar në shkresën të cilën KOSTT e ka pranuar nga ZRRE me datë 11 Dhjetor 2020, lidhur me prezantimet e planeve të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), përkatësisht me shqyrtimet dhe azhurnimet vjetore të tarifave të energjisë elektrike, të cilat pritet të hyjnë në fuqi më 1 Prill 2021, KOSTT ka përgatitur të dhënat për përshtatjet e vitit 2020 si dhe parashikimet për vitin 2021, sipas formularëve të pranuar.

Kësaj shkrese i bashkëngjiten dokumentet:


210127_KOSTT_Azhurnimet vjetore për tarifat e KOSTT që pritet të hyjnë në fuqi më 1 Prill 2021

210127_KOSTT_Pershtatjet vjetore_KOSTT_2020-2021

210127_KOSTT_Lista e Projekteve Kapitale_2020-2021

Lusim Bordin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për shqyrtimin e të dhënave të paraqitura në dokumentin e bashkëngjitur dhe aprovimin e kërkesave të KOSTT.

Sinqerisht,


Mustafë Hasani
Kryeshef Ekzekutiv



Cc.

z.Selman Hoti, Anëtar i Bordit të ZRrE,
z.Petrit Pepaj, Drejtor Menaxhues i ZRrE,
z.Ymer Fejzullahu, Udhëheqës i Departamentit për Tarifa dhe Çmime në ZRrE,

27.01.2021

**Azhurnimet vjetore për tarifat e KOSTT që pritet të hyjnë në fuqi më 1 prill
2021**

Arsyeshmëri për kërkesat dhe ndryshimet operative dhe kapitale

Janar 2021

Përmbajtja:

1.0	Hyrje	3
2.0	Të Hyrat.....	3
3.0	Shpenzimet Operative	3
3.1	Shpenzimet e Mirëmbajtjes	4
3.2	Shpenzimet tjera operative	4
3.3	Shpenzime operative të lidhura me operimin e KOSTT si zonë rregulluese.....	4
3.4	Shpenzimet e Humbjeve në Transmision.....	6
3.5	Shpenzimet e Shërbimeve Ndihmëse	6
4.0	Fondi për energjinë e ripërtëritshme	8
5.0	Arsyeshmëria për projektet e mos realizuara sipas Planit Investiv 2018-2022 - kërkesë për projekte të reja.....	9
5.1	Projektet e Transmisionit	9
5.2	Projektet e Sistemit	10
6.0	Përmbledhje.....	35

1.0 HYRJE

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me datën 11 Dhjetor 2020 ka iniciuar procesin e azhurnimit vjetor të shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike për vitin 2021.

Bazuar në obligimet që dalin nga Rregulla e Çmimeve për OST/OT-në, KOSTT në vijim paraqet raportin për shpenzimet dhe të hyrat e realizuara gjatë vitit 2020, si dhe kërkesat në këto pozicione për vitin 2021.

Po ashtu paraqiten ndryshimet në Investimet Kapitale sipas Modelit për Përshtatjet e Rregullta Vjetore të ZRRE si dhe arsyeshmërinë për kërkesat e ndryshimeve të Investimeve Kapitale 2020-2021.

2.0 TË HYRAT

Në bazë të Vendimit të Bordit të ZRRE-së, me nr. V_1238_2020 të datës 06.04.2020, të Hyrat e Lejuara për vitin relevant tarifar 1 prill 2020 – 31 mars 2021 për KOSTT kanë qenë 45,884,164 €.

Në tabelën më poshtë mund të shihen të dhënat për të hyrat e lejuara dhe të realizuara për vitin kalendarik 2020.

Tabela 1. Të Hyrat e Lejuara dhe të Realizuara në vitin kalendarik 2020

Të Hyrat 2020 Janar-Dhjetor	Njësia	Parashikimi	Realizimi	Ndryshimi	%
Të hyrat nga 400/220 kV	€000s	394.88	419.31	24.42	106%
Të hyrat nga 110 kV	€000s	17,605.68	19,660.24	2,054.56	112%
Të hyrat nga SO	€000s	9,813.83	12,335.25	2,521.42	126%
Të hyrat nga MO	€000s	289.23	352.18	62.94	122%
Të Hyrat nga BRE	€000s	17,780.54	15,533.01	(2,247.53)	87%
Total të Hyrat	€000s	45,884.16	48,299.98	2,415.81	105%

Shihet se në total të hyrat e realizuara janë 5% më të larta se ato të lejuara. Kjo ka ndodhur përveç dallimit në mes të vitit tarifar dhe vitit kalendarik, po ashtu edhe për arsye të llogaritjes së tarifave me pikun e ndryshëm krahas atij në të cilin janë faturuar të hyrat si dhe rrjedhat e energjisë.

3.0 SHPENZIMET OPERATIVE

Për vitin 2020 KOSTT-it i janë lejuar në emër të shpenzimeve operative 7,281.24 €. Në kuadër të shpenzimeve operative hyjnë shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes, shpenzimet e personelit, shpenzimet e shërbimeve komunale dhe shpenzimit tjera operative.

Të realizuara për këtë periudhë janë 7,436,699 €.

Për vitin 2021 të lejuara sipas shqyrtimit pesëvjeçar të ZRRE-së janë 7,091,274 €. Ndërsa sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2021 janë planifikuar 8,695,812 €.

Ndërsa sa i përket shpenzimeve operative të lidhura me operimin e KOSTT si zonë rregulluese për vitin 2021 për vitin 2021 janë planifikuar 735,000 €.

Në total kërkesa e KOSTT për shpenzime operative është 9,430,812 €.

Tabela 2. Kërkesa e KOSTT për total shpenzime operative për vitin 2021

TOTAL SHPENZIMET OPERATIVE	Kërkesa për vitin 2021
Shpenzimet tjera operative	7,648,319
Mirëmbajtja	1,047,493
Shpenzimet operimit të KOSTT si zonë rregulluese	735,000
TOTAL SHPENZIMET OPERATIVE	9,430,812

3.1 Shpenzimet e Mirëmbajtjes

Shpenzimet e lejuara të mirëmbajtjes për vitin 2020 kanë qenë 1,056.40 €. Shpenzimet e realizuara të mirëmbajtjes gjatë vitit 2020 janë 752,736 €.

Për vitin 2021 të lejuara sipas shqyrtimit pesëvjeçar të ZRRE-së janë 1,029,258 €. Ndërsa sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2021 janë planifikuar 1,047,493 €.

3.2 Shpenzimet tjera operative

Shpenzimet tjera operative për periudhën 2018-2022 janë të lejuara së bashku me shpenzimet e personelit dhe shërbimet komunale. Për vitin 2019 të lejuara kanë qenë 6,224.84 €. Të realizuara për këtë periudhë janë 6,683,964€.

Për vitin 2021 të lejuara sipas shqyrtimit pesëvjeçar të ZRRE-së janë 6,062,016 €. Ndërsa sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2021 janë planifikuar 7,648,319€.

3.3 Shpenzime operative të lidhura me operimin e KOSTT si zonë rregulluese

Pas implementimit të Marrëveshjes së kycjes KOSTT-ENTSO-E, KOSTT që nga 14 Dhjetor 2020 ka filluar operimin si Zonë rregulluese në kuadër të bllokut Shqipëri-Kosovë, i njohur si blloku rregullues AK.

Operimi si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues AK përfshinë kryesisht aktivitete që ndërlidhen me bashkëpunimin e OST-ve fqinje, rajonale e më gjerë, me qëllim të operimit të sigurtë të sistemit. Bashkëpunimi i ngushtë i OST-ve bazohet në parimin e respektimit të rregullave dhe kodeve teknike Europiane.

Për shkak të fillimit të operimit në kuadër të Bllokut, në KOSTT duhet që gjatë gjithë fazave të planifikimit, operimit në kohë reale dhe fazave pas operative së operimit në modin e ri si

LFC Zonë në kuadër të AK LF C Bllokut, KOSTT është i obliguar që të shkëmbej informacionet operative me të gjitha OST fqinje, Qendrat regjionale dhe Qendrën Koordinative Swissgrid, duke shfrytëzuar shërbimet e ofruara nga Platformat e ndryshme të ENTSO-e, paraprakisht të kontraktuara për qasje në to, si kusht i domosdoshëm për implementimin e Marrëveshjeve operative me ENTSO-E dhe OST fqinje, të cilat ndërlidhen me:

- Analiza e punës së sistemit një ditë para dhe gjatë ditës;
- Nominimi i programit ndërkufitar dhe programeve të palëve tregtare një ditë para në formë të autorizuar përmes softuerëve dhe platformave adekuate;
- Krijimi i modelit referent të rrjetit për SEE të Kosovës për qëllim të llogaritjeve të parametrave të sigurisë së operimit, veprimi adekuat në rrethana emergjente, përpunimi i planit të ri mbrojtës, alokimi i kapacitetit dhe llogaritja e kongestionëve;
- Dërgimi i të dhënave të nevojshme përmes platformave të cilat KOSTT duhet ti ketë, për në platformën e transparencës në ENTSO-E, etj;
- Shkëmbimi i të dhënave të nevojshme përmes platformave regjionale të RSC dhe integrimi në rrjetin regjional dhe paneuropian me qëllim të analizave për kongestionet e mundshme.

Në kuadër të monitorimit të performimit të KOSTT-it, ENTSO-E ka krijuar grupin prej ekspertëve (PG TSO KOSTT) për vlerësimin e KOSTT-it në plotësimin e kërkesave të cilat dalin nga SOGL (System Operation Guideline) dhe SAFA (The Synchronous Area Framework Agreement), ku pjesë të konsiderueshme të detyrave dhe obligimeve të KOSTT-it janë direkt të lidhura me performimet e shkëmbimit të informacioneve me ofruesit e këtyre shërbimeve.

Vlenë të ceket se këta ofrues të shërbimeve janë unik për të gjitha TSO-të Evropiane. Këto ishin sa i përket shpenzimeve të planifikuara për Shpenzimet vjetore të parashikuara nga OST për pagesa kundrejt ENTSO-E si dhe Shërbime për RSC.

Shpenzime tjera që lidhen me fillimin e operimit janë pagesat kundrejt shërbimeve të kryera nga SEE CAO (Coordinated Auction Office in South East Europe) si dhe shpenzimet e planifikuara për shërbime ligjore të cilat parashihet të ndodhin lidhur me trajtimin e kontestit për borxhet e Serbisë ndaj Kosovë për alokimin e kapaciteteve.

Në vazhdim paraqitet tabela me kategoritë e shpenzimeve të cilat janë të lidhura direkt me operimin e pavarur të KOSTT-it si zonë rregulluese.

Tabela 3. Shpenzimet e operimit të KOSTT si zonë rregulluese

Shpenzimet e ndërlidhura me Operimin e Pavarur	2021
Shpenzimet ligjore për Borxhet nga Alokimi i Kapaciteteve	150,000
Shpenzimeve vjetore të parashikuara nga OST per pagesa kundrejt ENTSO-E	350,000
Sherbimet për RSC	150,000
Sherbimet për CAO	85,000
TOTALI	735,000

3.4 Shpenzimet e Humbjeve në Transmision

Niveli i Lejuar i Humbjeve në Transmision për vitin 2020 ishte 1.78% e energjisë së transmetuar për qëllim të konsumit të Kosovës. Kjo e shndërruar në vlerë absolute sipas rrjedhave të parashikuara të energjisë ishte 111.1 GWh. Me një çmim të humbjeve prej 46.46 €/MWh, të hyrat e lejuara për humbjet në transmision për vitin 2020 kanë qenë 5,158,960 €.

Gjendja aktuale sa i përket kostos së humbjeve në transmision është si vijon. Niveli i realizuar i humbjeve në transmision është 107.3 GWh i shprehur në përqindje 1.73% kurse në vlerë financiare 4,533,448 €.

Humbjet totale në sistem të transmisionit janë 113.3 GWh të cilat zvogëlohen për pjesën e humbjeve në transmision që i shkaktojnë humbjet në veri që është rreth 6 GWh.

Në bazë të Balancës së Aprovuar Vjetore të Energjisë Elektrike, humbjet e parashikuara në transmision për vitin 2021 do të jenë 113.5 GWh, kurse humbjet e sistemit 293 GWh (Konsumi Veriut të Kosovës). Sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2021 janë planifikuar 5,200,000 €.

3.5 Shpenzimet e Shërbimeve Ndhmëse

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, KOSTT menaxhon dhe operon me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës. Sipas Nenit 16 të këtij ligji ndër detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit është: "prokurimi i shërbimeve balancuese për balancim të sistemit, në bazë të parimeve të tregut dhe parimeve të transparencës dhe jo-diskriminimit". Gjithnjë sipas Ligjit për Energjinë Elektrike (Neni 19), Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të angazhohet në prokurimin e energjisë dhe kapacitetit, bazuar në procedura transparente, jo-diskriminuese dhe të bazuara në treg për qëllimet e balancimit të sistemit dhe ofrimit të shërbimeve ndihmëse.

Sipas Licencës (Neni 19) për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, i licencuari (KOSTT) do të jetë përgjegjës për aranzhimin e provizioneve të sasive dhe llojeve të shërbimeve ndihmëse, prokurimin e tyre në përputhje me ligjin për energjinë elektrike

dhe procedurat për prokurim, siç mund të jetë e nevojshme në mënyrë që të licencuarit të mundësohet kryerja e obligimeve të dhëna sipas kodit të rrjetit.

Bazuar në Ligjin për Energjinë Elektrike (Neni 22), KOSTT ka draftuar Procedurën për tregtimin e energjisë elektrike, e cila është miratuar nga ZRRE, në të cilën janë përcaktuar parimet e përgjithshme të blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

Në pajtim me Procedurën për Tregtimin e Energjisë të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, KOSTT është i obliguar të bëjë prokurimin për këto shërbime ndihmëse në tregun e energjisë elektrike nga ofruesit e shërbimeve të cilët i plotësojnë kushtet administrative dhe teknike të ofrojnë shërbimin e Rezervës aFRR dhe mFRR.

KOSTT, si Operator i Sistemit dhe Transmetimit, është i pajisur me licencën e lëshuar nga ZRRE për operimin teknik të rrjetit të transmetimit dhe operimin e sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës. Në kuadër të detyrave për operimin e sistemit, KOSTT është i obliguar që në përputhje me Kodin e Rrjetit në fuqi, të sigurojë operimin efikas të sistemit në kohë reale, duke balancuar SEE gjatë gjithë vitit, konkretisht çdo moment brenda 8760 orëve të vitit kalendarik. Balancimi në fjalë është i domosdoshëm për mundësimin e punës paralele me rrjetet e transmetimit të shteteve fqinje dhe atyre Evropiane. Që kjo të arrihet është detyrë licensore e KOSTT që të siguroi produktet balancuese, konkretisht shërbimet ndihmëse si rregullimi sekondar aFRR dhe rregullimin terciar mRR, përmes të cilave produkte do të jetë në gjendje të balancoi SEE të Kosovës në kohë reale.

Kjo do të thotë që në Zonën e Kontrollit të KOSTT-it, në çdo moment gjenerimi i energjisë elektrike (shtuar edhe importin) të jetë në balancë me konsumin e energjisë elektrike (shtuar edhe eksportin). Me fjalë të tjera diferenca në mes të këtyre dy komponentëve: (gjenerimi + importi) si dhe (konsumi + eksporti) të jete plotësisht i balancuar.

Gjithashtu, bazuar në direktivat dhe rregullativat e ENTSO-E siç janë SOGL (System Operation Guideline), EB (Electricity Balancing Network Code), NC LFCR (Network Code Load - Frequency Control and Reserves) etj., të cilat definojnë kushtet e domosdoshme për punë paralele interkonektive, secili Operator i Sistemit Transmetues obligohet që të balancojë sistemin transmetues në Zonën e vet të Kontrollit.

Aktualisht KOSTT ka nënshkruar Marrëveshjen e Kyçjes me RGCE\ENTSO-E, dhe është duke operuar si LFC Zonë e pavarur.

Bazuar në përshkrimet e cekura më lart KOSTT obligohet që të sigurojë blerjen e shërbimeve ndihmëse për balancimin e sistemit, konkretisht:

- Rregullimin terciar (+/- mRR manual Replacement Reserve): rregullimin terciar për ngritje (+mRR – pozitive manual Replacement Reserve) në vlerën 197MW Bazuar në Marrëveshjen e Bllokut AK në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë të sigurimit të rezervave në mes KOSTT dhe OST (TSO e Shqipërisë), KOSTT është i obliguar të sigurojë 72.97% të vlerës 270MW, konkretisht 197MW.
- Rregullimin terciar për zbritje (-mRR – negative manual Replacement Reserve) në vlerën 70 MW. Në bazë të analizave të bëra konform rregullave të ENTSO-E në fuqi, KOSTT është i obliguar që të sigurojë rregullimin terciar për zbritje (-mRR), në vlerën 70MW, sasi kjo që nevojitet për balancimin e SEE të Kosovës me rastin e paraqitjes së tepricave të en.el. në SEE të Kosovës.

Bazuar në Rregullën e OST/OT, kostot e lejuara të shërbimeve ndihmëse dhe balancuese për vitin 2021 propozohen nga OST/OT gjatë shqyrtimeve periodike dhe gjatë përshtatjeve të rregullta duke përdorur parashikimin për blerjet e nevojshme të shërbimeve OST për këtë vitin relevant dhe çmimet e parashikuara për këto blerje.

Buxheti i parashikuar për vitin 2021 është i bazuar në marrëveshjet e dakorduara për shërbime ndihmëse me OST me kosto të parapare në vlerë prej 9,528,669.13 € euro.

Kalkulimi për kostot e kapacitetit për rregullimin terciar mFRR në ngritje (197 MW) dhe zbritje të kapacitetit (70 MW), është paraqitur si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4. Kostot e kapaciteteve për shërbimet ndihmëse

Kostot e kapaciteteve për shërbime ndihmëse						
Muaji	kapaciteti (MW)	ditë/muaj	aFRR (çmimi 3 euro te dy drejtimet)	mFRR (në ngritje sipas kontrate)	mFRR (në zbritje sipas kontrate)	Gjithsej
Janar	36.0	31	160,639.20 €	615,585.60 €	109,368.00 €	885,659.78 €
Shkurt	32.9	28	132,516.00 €	607,642.56 €	108,192.00 €	848,411.43 €
Mars	30.4	31	135,913.93 €	746,031.12 €	132,804.00 €	1,014,810.49 €
Prill	27.8	30	120,025.05 €	733,312.80 €	130,032.00 €	983,427.63 €
Maj	26.4	31	117,723.57 €	757,756.56 €	134,366.40 €	1,009,903.90 €
Qershor	23.0	30	99,335.03 €	411,336.00 €	73,080.00 €	583,804.02 €
Korrik	24.3	31	108,558.56 €	425,047.20 €	75,516.00 €	609,177.08 €
Gusht	25.0	31	111,497.96 €	425,047.20 €	75,516.00 €	612,117.14 €
Shtator	24.4	30	105,428.31 €	411,336.00 €	73,080.00 €	589,898.72 €
Tetor	26.6	31	118,912.25 €	527,644.80 €	93,744.00 €	740,358.68 €
Nëntor	30.6	30	132,008.27 €	553,176.00 €	98,280.00 €	783,524.83 €
Dhjetor	36.0	31	160,523.98 €	600,928.80 €	106,764.00 €	868,283.74 €
Total			1,503,082.09 €	6,814,844.64 €	1,210,742.40 €	9,528,669.13 €

4.0 FONDI PËR ENERGJINË E RIPËRTËRITSHME

Bazuar në legjislacionin që mbulon fushën e energjisë Operatori i Tregut është menaxhues i Fondit për BRE. Llogaritjet për realizimet dhe parashikimet për këtë fond janë paraqitur në Modelin për Përshtatjet e Rregullta Vjetore. Vlera e estimuar për vitin 2021 është 18,539,544 €, ku përfshihet ndryshimi në mes të tarifave nxitëse dhe çmimit mesatar i vitit 2020, kosto e imbalancit 803,619 € si dhe kosto e menaxhimit të fondit që është llogaritur rreth 1% e këtij fondi.

Duhet theksuar se ekziston një dallim në mes të dhënave të raportuara për vlerat e realizuara të vitit 2020 nga Operatori i Tregut dhe Pasqyrat Financiare. Ky dallim është rezultat i përfshirjes së korrigjimeve të faturave për inflacionin në vite të ndryshme. Një pjesë e këtyre faturave nga OT është përfshirë si realizim në vitin 2019 kurse në pasqyra financiare janë përfshirë në vitin 2020

5.0 ARSYESHMËRIA PËR PROJEKTET E MOS REALIZUARA SIPAS PLANIT INVESTIV 2018-2022 - KËRKESË PËR PROJEKTE TË REJA

5.1 Projektet e Transmisionit

Projekti - NS Prishtina 4- Rehabilitimi i Hargjimit vetjak, Ormaneve AC/DC, Kablllove - Lidhur me rehabilitimin e hargjim eve vetjake ky projekt veç ka filluar se zbatuari ne muajin Tetor, mirëpo ka pasur dhe do te ketë vonese deri ne përfundimin e pajisjeve për shkak te liferimit te pajisjeve te cilat janë prodhuar ne vende te jashtme dhe si pasoje e pandemisë ka pasur pengesa. Vlera e kontratës/ Buxheti i planifikuar 150,000.00€, Vlera e Kontratës 127,118.64€. Statusi i Projektit: Në proces te ekzekutimit

Projekti - Rehabilitimi i kthinave AC 400V - Ky projekt është realizuar dhe është përfunduar konform specifikimit teknik dhe buxhetit te aprovuar nga ZRRE, nuk kemi pasur kosto shtesa ne këtë projekt. Vlera e kontratës/ Buxheti i planifikuar 20,000.00€, Vlera e Kontratës se realizuar 14,608.00€

Projekti - Furnizimi dhe Instalimi me UPS në ndërtesën Qendrore të KOSTT - Procesi i këtij projekti është Duke u zhvilluar , kontrata është nënshkruar ne muajin Dhjetor, është filluar me aprovime te materialeve përmes DTS-ve, si dhe një pjese e materialeve janë liferuar, besoi deri ne funde te muajt Janar fillimi i muajt Shkurt kjo kontratë do te përfundon. Vlera e kontratës/ Buxheti i planifikuar : 200,000.00€, Vlera e Kontratës se kontraktuar: 169,491.53€

Projekti ID/006" Linja e re 110 kV NS Rahovec- NS Theranda" - Ky projekt është në kuadër të projekteve të financuara nga BERZH (EBRD), i cili është realizuar dhe energjizuar më 18.06.2020. Projekti ka pasur disa vonesa si rezultat i vonesave për marrjen e lejeve për ndërtim, shpronësim dhe servitut. .Vlera e planifikuar e projektit 1,470 Mil €.

Projekti ID 046 "Furnizimi me pjesë rezervë për linjat, vjerrëse dhe shtrënguese, OPGW, joint-box dhe pajisje tjera përcjellëse" - Në kuadër të këtij projekti janë shpenzuar 200,000.00€ për vitin 2020.

Projekti ID 048 "Furnizimi me pjesë rezervë për nënstacione" - Në kuadër të projektit: Furnizimi me pjesë rezervë për nënstacione janë shpenzuar 250,000.00€ për vitin 2020.

Furnizimi dhe montimi i shenjave për sinjalizim të linjave sipas kërkesës së Aviacionit Civil - Projekti është tenderuar dhe ka filluar me implementim , por përfundon në vitin 2022. Në kuadër të këtij projekti gjatë viti 2020 janë shpenzuar 76,000€

Furnizimi dhe Instalimi me UPS në ndërtesën Qendrore të KOSTT- Projekti ka përfunduar dhe vlera e tij është 137,216.3€ (pa TVSH)

Projekti ID/ 004/3" Linja e dyfishtë kablllovi 110 kV NS Fushe Kosova" - Ky projekt është në kuadër të projekteve të financuara nga BERZH (EBRD), i cili ka pas vonesa në marrjen e lejeve për ndërtim, shpronësim dhe servitut, prandaj projekti i paraparë për përfundim në vitin 2020 shtyhet deri në Q2 2021. Vlera e planifikuar e projektit 1,470Mil €.

Grupi i projekteve për të cilat janë përgatitur specifikimet teknike dhe janë në procesin e tenderimit :

- a. **Projekti (ID/049): NS Kastrioti (Ferizaj 3) 110/10(20) kV me linja transmetuese ;**
- b. **Projekti (ID/004) :NS 110/10(20) kV -Fushë Kosova GIS**
- c. **Projekti (ID/011) :NS 220/10(20) kV-Malisheva me linjat transmetuese 220kV;**

Për këtë grup të projekteve të rëndësishme stafi i KOSTT-it ka përgatitur specifikimin teknik me kohë. Është shpallur tenderi dhe ka përfunduar edhe faza e pyetjeve sqaruese, evaluimit konform ligjeve të prokurimit të Kosovës ,por ende nuk është përzgjedhur fituesi.

Projektet ID (009, 010, 011, 012, 013, 014, 015, 016 dhe 017) e fazës së VI dhe VII –KfW - Sipas planit investiv ky grup i projekteve është planifikuar të financohet me kredi nga KfW, përmes shërbimeve konsulente në vitin 2020 përfshirë specifikimin teknik për projektet ndërsa realizimi gjatë vitit 2020-2022, por për shkak të mos arritjes së marrëveshjes së kredisë projekti është shtyrë.

“Marrëveshja për kredi ndërmjet KOSTT dhe KfW për Fazën VI-VII është iniciuar qysh në vitin 2013, ndërsa fillimi formal i nismës për lidhjen e marrëveshjes për kredi është miratuar nga Qeveria e Kosovës me 08.09.2016 me Vendimin Nr. 03/108, ndërsa negociatat formale ndërmjet KOSTT, Ministrisë së Financave dhe KfW janë mbajtur me 13 dhe 14 nëntor 2017. Që nga Dhjetori 2017 për shkak të implikimeve politike në Kosovë si dhe obstrukcioneve nga Serbia për fillimin e operimit të pavarur të KOSTT, vazhdimi i mëtejshmë i procedurave për nënshkrimin e Marrëveshjes për Kredi për Fazën VI-VII është pezulluar me kërkesë të palës gjermane/KfW, dhe atë deri në qartësimin e pozicionit të KOSTT për operimin e pavarur dhe futjen në operim të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri. “

Pas një procesi të gjatë disa vjeçar Marrëveshja e re e Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, hyri në fuqi më 14 Dhjetor 2020. Me këtë, më në fund u bë realitet operimi i pavarur i KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë si dhe pas më shumë se katër vite që nga përfundimi i ndërtimit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri në të dy anët e kufirit, më 14 Dhjetor 2020 përfundimisht linja e njohur si “Autostrada Energjetike Kosovë-Shqipëri” komercialisht u vu në funksion , shpresojmë dhe besojmë se edhe Marrëveshtja me KfW rreth kredisë do të realizohet dhe në vitin 2021 do të fillon procedurat për realizim të projekteve .

Ky Grup i projekteve do të pësoj ndryshime pasi që disa nga projektet për shkak të urgjencës do të financohen më herët nga buxheti i KOSTT . Periudhën e planifikuar për implementim të projekteve do të jetë në vitin 2022-2024. Vlera e planifikuar e projekteve do të ndryshojë dhe do të jetë 42,500,000.00€ (25,500,000.00 kredi nga KfW dhe 19,500,000.00 nga buxheti i KOSTT-it) .

ID 053 “Furnizim me 20 copë pajisje Meter Data Collection për nënstacionet distributive 110/x kV” - Projekti i paraparë për realizim në vitin 2019 shtyhet për vitin 2022.

Projekti ID 055 “Rehabilitimi i NS Prishtina 2 dhe NS Deqani” (Ndërrimi i ndarësve 110kV)- Ky projekt planifikohet të realizohet gjatë vitit 2020 dhe për shkak të volumit të ndërrimit të pajisjeve vlera i rritet në 271,000€, mos aprovimi i rritjes së buxhetit nga ZRRE në vitin 2020 ka rezultuar në mos realizimin e projektit .

5.2 Projektet e Sistemit

Projekti „Punimi i rrethojës dhe ndriçimit në NS Theranda, SSh Drenas, NS Vitia etj” - Për këtë projekt kërkesa në ZRRE është paraqitur edhe në vitin e kaluar (kërkesë për realizim në vitin 2020). Duke konsideruar rëndësinë e lartë nga aspekti i sigurisë fizike të këtyre nënstacioneve, kjo kërkesë është paraqitur edhe në planin e buxhetit për vitin 2020. Kërkesa është shqyrtuar nga menaxhmenti i lartë, me të gjitha arsyetimet (ashtu si është dhënë në tekstin si ma poshtë), dhe është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT me aprovimin e Buxhetit të rishikuar, gusht 2020.

Për këto projekte është planifikuar buxhet 150,000.00 euro.

Prandaj, paraqesim kërkesë për shqyrtim dhe aprovim të këtij projekti në planin Investiv 2018-2021.

Shqyrtimi i problemit - NS Theranda është një nënstacion mjaft i rëndësishëm në sistemin elektroenergjetik të Kosovës i cili furnizon me energji elektrike qytetin e Therandës dhe fshatrat për rreth.

Në Therandë gjendet edhe një zonë industriale mjaftë e fuqishme duke marr parasysh rrethanat ekonomike të Kosovës, e që gjithashtu kjo zonë furnizohet me energji elektrike nga ky NS.

Ky NS si nyje energjetike furnizohet nga tri linja 110kV dhe bënë transformimin e energjisë elektrike në nivelin e mesëm të tensionit 35kV dhe 10kV përmes dy transformatorëve me fuqi 31.5kVA, TR1 110/10kV/kV me fuqi 31.5kVA dhe TR2 110/35/10kV me fuqi 31.5kVA.

KOSTT viteve të fundit ka bërë investim të madh në këtë nënstacion duke e bërë ndërrimin e pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV, pajisjeve të tensionit të mesëm 35kV dhe 10kV si dhe tensionit të ulët si Mbrojtje dhe kontroll.

Pajisjet e montuara janë nga teknologjia e fundit, ku vlen të ceket se pajisjet 110 kV janë të sistemit GIS.

Me që rrethoja e objektit dhe ndriçimi i saj nuk kanë qenë pjesë e investimit paraprak, ndërsa gjendja e saj nuk i përmbushë standardet e sigurisë për objektet të kësaj rëndësie të lartë është i domosdoshëm ndërtimi i rrethojës së re.



Foto e rrethojës aktuale në NS Theranda



Foto e hyrjes aktuale në NS Theranda

Gjithashtu në vazhdimësi duhet të intervenohet në punimin e rrethojave të reja në NS Vitia dhe S SH Drenas, dhe të cilat i kanë rrethojat tejet të vjetruara dhe të dëmtuara nga korrozioni, si dhe lartësia e tyre aktualisht nuk i plotësojnë kriteret është e mjaftueshme për objektet energjetike.



Foto e rrethojës aktuale në NS Vitia

Përmbajtja e përgjithshme e projektit

Në kuadër të këtyre projekteve përfshihet:

- ndërtimi i rrethojës së re metalike, të zinkuar;
- dyerve automatike, monitorimit të hyrjes dhe kontrollimit nga distanca,
- ndriçimit të rrethojës sipas standardeve të parapara teknike për NS.

Objektivat e projektit dhe përfitimet - Objektiva primare e realizimit të këtyre projekteve është ngritja e sigurisë në NS dhe mbrojtja e aseteve vitale të KOSTT që ato të mbahen të pacenuara, duke mos u rrezikuar për asnjë moment funksionimi normal i punës nëpër objekte dhe nënstacione të KOSTT-it të cilat do të mund të ndikonin në sigurinë e punëtorëve, aseteve si dhe tërë Sistemit elektroenergjetik.

KBA e Projektit - Bazuar në shpjegimet e dhëna në paragrafin 2.1 të referuara në tabelën 1, në projektin e kategorisë mbështetëse të sistemit nuk mund të zbatohet metodologjia e aprovuar e KBA-se.

Plani i implementimit të projektit - Duke u bazuar në gjendjen e prezantuar më lartë si dhe çmimet referente të punëve të ngjashme të realizuara gjat tani kërkesa për buxhet për këto Projekte në total është 150.000,00Euro (me tvsh).

Gjatë vitit 2020 është filluar procedura për realizim të projektit për NS Therranda dhe SSH Drenas, ndërsa realizimi i projektit për NS Vitia do të fillojë në vitin 2021.

Në vitin 2020 janë realizuar 20,000.00 euro, ndërsa në vitin 2021 planifikohet të realizohen 130,000.00 euro.

Projekti "Punimi i depozitës së mbyllur në Obiliq"

Për këtë projekt kërkesa në ZRRE është paraqitur edhe në vitin e kaluar (kërkesë për realizim në vitin 2020). Duke konsideruar rëndësinë e lartë për hapësira për deponim të pajisjeve si pjesë rezerve dhe materiale tjera të nevojshme për punë, të cilat vlerësohen me vlera të larta, si dhe duke marrë parasysh se janë shtuar shumë me rritjen numrit të aseteve të KOSTT, kjo kërkesë është paraqitur edhe në planin e buxhetit për vitin 2020. Kërkesa është shqyrtuar nga menaxhmenti i lartë, me të gjitha arsyetimet (ashtu si është dhënë në arsyetimin e tekstit si më poshtë), dhe është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT me aprovimin e Buxhetit të rishikuar, gusht 2020.

Ky projekt është në procedurë të prokurimit dhe planifikohet të realizohet në vitin 2021.

Prandaj, paraqesim kërkesë për shqyrtim dhe aprovim të këtij projekti në planin Investiv 2018-2021.

Shqyrtimi i problemit - Në Obiliq (Kastriot) pranë NS 400kV Kosova B gjendet depoja dhe punëtorja e KOSTT ku deponohen të gjitha pjesët rezervë të nevojshme për intervenimet e rregullta si dhe ato emergjente e të gjitha NS dhe linjave të cilat mirëmbahen nga KOSTT.

Pasi që gjatë periudhës katërmëdhjetë vjeçare këto asete të KOSTT janë rritur, edhe nevoja për hapësira për deponim është shtuar shumë.

Përveç kësaj, mos ekspozimi i materialit në depo të hapur, ka qenë shumë herë kërkesë e jona, por edhe e kompanisë së sigurimit fizik. Andaj, ndërtimi i një depoje të mbyllur nga konstrukcioni metalik në këtë pjesë do të kishte impakt pozitiv në shumë aspekte.

Fillimisht, materiali nuk do të ishte i ekspozuar ndaj kushteve të ndryshme klimatike, në aspektin e sigurisë fizike do të ishte më i sigurtë, si dhe menaxhimi i tij padyshim që do të ishte më i kontrollueshëm.

Gjithashtu në vazhden e shtimit të masave të sigurisë nëpër objektet e KOSTT-it, meqenëse si pjesë më e atakuar ka qenë dhe është pjesa e Depos, është e domosdoshme ngritja e nivelit të sigurisë në këtë pjesë.

Përmbajtja e përgjithshme e projektit - Në kuadër të këtij projekti përfshihet:

- Punimi i konstrukcionit metalik për ndërtimin e depos;
- Mbyllja dhe mbështjellja e fasadës me sandwich panele;
- Punimi i dymave, dritareve, dyshemesë, etj.

Objektivat e projektit dhe përfitimet - Objektiva primare e realizimit të këtij projekti është se shpeshherë në pamundësi për t'i sistemuar në depo të mbyllur materialin (pjesët, asetet) me vlerë të konsiderueshme materiale, ato mbesin në hapësirën e depos së hapur, çka edhe paraqet problem si dhe rritë në masë të konsiderueshme gjasat për keqpërdorim, duke mos anashkaluar vjedhjen nga personat e pandërgjegjshëm. Realizimi i tij do të mundësonte shtimin e hapësirës për pjesët rezervë të domosdoshme për intervenime si dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre, duke marrë në konsideratë vlerat e tyre të larta.

Plani i implementimit të projektit - Ky projekt është në procedurë të prokurimit dhe dhe planifikohet të realizohet në vitin 2021.

KBA e Projektit - Bazuar në shpjegimet e dhëna në paragrafin 2.1 të referuara në tabelën 1, në projektin e kategorisë mbështetëse të sistemit nuk mund të zbatohet metodologjia e aprovuar e KBA-së

Projekti: "Implementimi i Bllokut kontrollues AK" - Gjatë vitit 2020 është realizuar blerje e pajisjeve në vlerë 30,00.00 euro, pajisje që shërbejnë për realizim të bartjes së të dhënave për Bllokun AK, të dhënat nga nënstacionet që lidhen me interkoneksion (nënstacionet NS Podujeva, Berivojca, Vallaq, Prizreni 2).

Pritet që gjatë vitit 2021 do të ketë investime tjera të cilat duhet të realizohen në momentin kur të koordinohen veprimet me SwisGrid. Duke marrë parasysh se është e vështirë të bëhet vlerësim i përafërte/i saktë, dhe për t'u siguruar që mos të kemi pengesa për realizim të zhvillimeve të pritura për vitin 2021, KOSTT paraqet kërkesë për rritje të buxhetit për këtë projekt nga 100,000.00 të lejuara në 300,000.00 euro.

Kërkesë për rritje të vlerës së Projektit

Projekti: "Renovimi i Ndërtesave Komanduese" - Për këtë projekt kërkesa në ZRRE është paraqitur edhe në vitin e kaluar (kërkesë për realizim në vitin 2020). Duke konsideruar rëndësinë e lartë nga aspekti i efikasitetit të energjisë si dhe obligimi për krijimin e kushteve me të mira dhe me të sigurta për punë të operatorëve në nënstacione, kjo kërkesë është paraqitur edhe në planin e buxhetit për vitin 2020. Kërkesa është shqyrtuar nga menaxhmenti i lartë, me të gjitha arsyetimet (ashtu si është dhënë në tekstin si më poshtë), dhe është aprovuar nga Bordi i Drejtoreve të KOSTT me aprovimin e Buxhetit të rishikuar, gusht 2020.

Për nënstacionet NS Gjakova 2, NS Prishtina 3 dhe NS Podujeve janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe realizimi pritet të kryhet në vitin 2021. Ndërsa projekti për NS Prishtina 4 është planifikuar në vitin 2021.

Prandaj, bazuar në planin për realizim të këtyre projekteve paraqesim kërkesë që për këtë projekt të aprovohet rritje e buxhetit për 150,000.00 euro.

Shqyrtimi i problemit - Duke u bazuar në përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës, krijimit të ambienteve për punë në të gjitha objektet e KOSTT, si dhe në efikasitetin e energjisë, është rritur edhe nevoja për investime në Ndërtesat komanduese të NS andaj edhe është kërkuar rritja e vlerës së përcaktuar me buxhetin 2018-2020 për vlerën 150,000 €. Në kuadër të këtyre projekteve prioritet ju është dhënë eliminimit të materialeve të rrezikshme, pastaj ndërrimit të dritareve dhe dyerve me qelq të njëfishtë, në të cilat gjendja e dritareve në dhomat e kthinave është e rëndë dhe për këtë kemi shpenzime të mëdha të energjisë elektrike dhe shpesh ka ndodhur edhe rënia nga puna e NS për shkak të kondensimit dhe lagështisë.

Përmbajtja e përgjithshme e projektit - Në kuadër të këtyre projekteve përfshihet:

- ndërrimit të dritareve dhe dyerve me qelq të njëfishtë duke i zëvendësuar me ato të aluminit me ura termike dhe qelq termopan termik;
- mbështjellja e fasadave me material termoizolues;
- vendosja e ndriçimit eficient në objekt;
- largimit të tepisoneve nga sallat komanduese, krijimi i kuzhinave doracake për punëtorët të cilët punojnë në ndërtime.

Objektivat e projektit dhe përfitimet - Objektiva primare e realizimit të këtyre projekteve është efikasiteti i energjisë si obligim Ligjor, përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës, krijimit të ambienteve për punë në të gjitha objektet e KOSTT.

Plani i implementimit të projektit - Për nënstacionet NS Gjakova 2, NS Prishtina 3 dhe NS Podujeve janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe realizimi pritet të kryhet në vitin 2021. Ndërsa projekti për NS Prishtina 4 është planifikuar në vitin 2021.

KBA e Projektit - Bazuar në shpjegimet e dhëna në paragrafin 2.1 të referuara në tabelën 1, në projektin e kategorisë mbështetëse të sistemit nuk mund të zbatohet metodologjia e aprovuar e KBA-së.

Projekti ID 034 “Migrimi drejt sistemeve të avancuara telekomunikuese” - Fushëveprimi i këtij projekti është që të fillohet me implementimin e rrjetit optik DWDM dhe/ose MPLS kombëtar/ndërkombëtar duke përdorur infrastrukturën fibër optike ekzistuese të KOSTT-it me lokacione dhe resurse.

Migrimi drejt sistemeve të avancuara telekomunikuese duhet të përshatet edhe me projektin “Iniciativa për Autostradën Digjitale Ballkanike” të udhëhequr nga Banka Botërore. Në kuadër të Iniciativës për Autostradën Digjitale Ballkanike(ADH), KOSTT ka përfituar grant nga Banka Botërore (projekt me OST-te pjesëmarrëse nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Malit të Zi) për Asistencë teknike profesionale për mbështetjen për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit(SF), analizën e kost-benefitit dhe dizajnin paraprak që duhet të merret parasysh në fazën tjetër të projektit për përgatitjen tender dokumentacionin dhe Dizajnin e detajuar (Master plan).

Tabela 3. Plani i Implementimit për Iniciativën për Autostradën Digjitale Ballkanike

Aktiviteti	Data e fillimit	Data e përfundimit
Nënshkrimi i grantit për asistencë	01/2020	02/2020

teknike		
Përgatitja e Termave të Referencës për asistencë teknike profesionale	01/2021	02/2021
Fillimi dhe përfundimi i aktiviteteve	05/2021	10/2021

Për shkak të vonesës së fillimit të aktiviteteve të Asistencës Teknike Profesionale, gjatë vitit 2020 nuk ka qenë e mundur të realizohet projekti "Migrimi drejt sistemeve të avancuara telekomunikuese" sipas planit për vitin 2020.

Duke marrë parasysh vonesat e paraqitura në projektin ADH, si dhe kërkesat e ENTSO-E, është bërë vlerësim për veprimet e domosdoshme për të filluar me realizim të projektit për qëllime të shërbimeve për KOSTT, dhe atë bazuar në të gjitha të cekura si në vijim:

Gjatë zhvillimit dhe implementimit të projekteve janë rritur edhe kërkesat për shërbime dhe kapacitete shtesë përmes sistemit ekzistues telekomunikues.

Me rrjetin e sistemit të pajisjeve ekzistuese telekomunikuese SDH/PDH nuk ka mundësi të realizohen kërkesat për shërbime tjera dhe kapacitete shtesë, për shkak të fyteve të ngushta (shfrytëzim maksimal i kapacitetit në linçet telekomunikuese) në pikat grumbulluese të të dhënave. Vlen të theksohet që sistemi ekzistues nuk ka mbështetje teknike nga prodhuesi (End of Support, End of Life).

Gjithashtu është kërkesë nga ENTSO-E dhe Electronic Highway Technical Reference Manual (TRM) për implementimin e teknologjisë MPLS-TP në sistemin e telekomunikacionit në Operatorët e Sistemit të Transmisionit.

Implementimi i këtij projekt do të ketë në konsiderim dy pjesë:

- Pjesa Nacionale - Instalimi i pajisjeve për rrjetin telekomunikues për kërkesa të KOSTT
- Pjesa Internacionale - instalimi i pajisjeve për linkun KOSTT-OST (Pilot projekti KOSTT-OST)

Pjesa ndërkombëtare e rrjetit do të ofrojë disa kanale lambda (10 G ose 40 G) midis KOSTT dhe OST (që do të realizohet me pajisje DWDM përmes pilot projektit në vitin 2021).

Interkoneksionet me vendet tjera fqinje (Maqedonia Veriore, Mali i Zi, etj) planifikohen të realizohen bazuar në rekomandimet e projektit të Autostradës Digjitale Ballkanike.

Realizimi i projektit në tërësi në të gjitha nënstacionet (42 nënstacione) dhe qendrat dispečerike në QND dhe QNDE kërkon kosto shtesë në krahasim me realizimin e planifikuar më parë. Vlerësimi për realizim të këtij projekti është me vlerë 2.5 mil euro.

Kosto e paraparë për realizimin e projektit Migrimi drejt sistemeve të avancuara telekomunikuese (MPLS-TP) është bazuar në çmimet e tregut dhe konsultimet me Operatorët e Sistemit të Transmisionit fqinjë të cilët kanë implementuar apo janë në procedurë të implementimit të teknologjisë MPLS-TP.

Qëllimi i këtij projekti është:

- Do të plotësohen kushtet e kërkuara nga ENTSO-E dhe Electronic Highway Technical Reference Manual (TRM)
- Të zgjerohet rrjetin ekzistues të telekomunikimeve për të mbështetur më mirë shërbimet e brendshme,
- Si kompani publike është gjithashtu e rëndësishme të nxis zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe komunikimeve të Kosovës
- Për të krijuar infrastrukturë, përvojë dhe njohuri për të përmbushur me sukses sfidën e rrjeteve të zgjuara të së ardhmes,

- Përmes pilot projektit me pajisje DWDM për linkun KOSTT-OST do të ofrohen shërbime si kapacitete në tregun e telekomunikimeve në mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Për realizimin e këtij Projekti nevojiten këto aktivitete:

- Përgatitja e tender dokumentacionit
- Vendosja e elementeve aktive të rrjetit
- Integrimi i plotë në rrjetin ekzistues të KOSTT-it
- Integrimi i plotë me rrjetet interkonektive të OST-ve fqinjë
- Implementimi i pilot projektit KOSTT-OST me pajisje DWDM

Plani i implementimit dhe buxheti

-	Draft propozimi për dizajnimin e projektit	shkurt 2021
-	Specifikimet teknike	qershor 2021
-	Publikimi i tenderit	shtator 2021
-	Buxheti për vitin 2021	750,000.00 euro
-	Buxheti për vitin 2022	1,750.000 euro

Iniciativa për Autostradën Dixhitale Ballkanike

Kjo iniciativë synon të përmirësojë qasjen në shërbimet brez-gjerë (broadband) me shpejtësi të lartë, në nivel kombëtar dhe rajonal, brenda dhe midis vendeve të Ballkanit, përmes krijimit të një rrjeti rajonal me shpejtësi të gjerë të bazuar në infrastrukturën fibër optike të OST-ve pjesëmarrëse.

Falë rezultateve të këtij Projekti, OST-të do të jenë në gjendje të bashkëpunojnë me njëri tjetrin dhe të ofrojnë shërbime interkonektive.

Projekti synon të implementohet përmes nën-projekteve nacionale dhe do të strukturohet brenda tri komponenteve kryesore:

Komponenta 1: Asistenca Teknike (AT) për mbështetjen e implementimit të Projektit. Implementimi i Projektit do të bazohet në rezultatet e Asistencës Teknike i cili përfshin: Studimin e fizibilitetit (SF) dhe analizën e kost-benefitit, Dizajnin paraprak, Tender dokumentacionin dhe Dizajnin e detajuar (Master plan).

Komponenta 2: Zhvillimi rajonal dhe ngritja e kapaciteteve.

Kjo komponentë do të mbështes implementimin e shërbimeve rajonale për bashkë-shfrytëzimin e infrastrukturës përmes marrëveshjeve rajonale dhe ngritjes së kapaciteteve brenda OST-ve.

Komponenta 3: Infrastruktura Dixhitale

Nënkomponenta 3.1 Bazuar në rezultatet e komponentës 1, projekti do të përqendrohet në nivelin kombëtar të infrastrukturës së OST-ve dhe do të përfshijë implementimin e pajisjeve në nyjet telekomunikuese të rrjeteve kombëtare.

Nënkomponenta 3.2 bazuar në rezultatet e komponentës 1, projekti do të përqendrohet në nivelin ndërkombëtar të infrastrukturës së OST-ve dhe do të përfshijë implementimin e pajisjeve në nyjet telekomunikuese të rrjeteve ndërkombëtare/ndërkufitare të OST-ve pjesëmarrëse.

Plani i implementimit dhe buxheti - Plani i implementimit të projektit ADB nuk mund të definohet tani, kjo do të jetë pjesë e punës së Asistencës Teknike që do të angazhohet sipas iniciativës së BB, dhe me planin si ne vijim:

Aktiviteti	Data e fillimit	Data e përfundimit
Nënshkrimi i grantit për asistence teknike	01/2020	02/2020
Përgatitja e Termave të Referencës për asistence teknike profesionale	01/2021	02/2021
Fillimi dhe përfundimi i aktiviteteve	05/2021	10/2021

*Vërejtje : Nëse vlera buxhetore e paraparë për realizimin e këtij Projekti nuk është e mjaftueshme, atëherë parashihet që pjesa e mbetur të realizohet në kuadër të Projektit KODE (Kosovo Digital Economy).

Nga ajo që u tha më lartë, sqarohen arsyet për mos fillimin e realizimit të Projektit: Migrimi drejt sistemeve të avancuara telekomunikuese, sipas Planit për vitin 2020.

Projekti ID 032 “Përfshirja e nënstacioneve të reja në sistemin SCADA/EMS në QND dhe QEND” - Ndërtimi i nënstacioneve Drenasi 2, Mitrovica 2, Prishtina 6 , si dhe Rehabilitimi i nënstacionit Theranda, janë përfshirë në kuadër të projekteve të financuar nga EBRD (kredi afatgjatë me kushte të volitshme). Në kuadër të kësaj pakete nuk ka qenë e përfshirë edhe Integrimi i nënstacioneve të cekura në sistemin SCADA/EMS në Qendrën Nacionale Dispečerike(QND) dhe Qendrën Emergjente Nacionale Dispečerike(QEND).

Duke pasur parasysh se ndërtimi i nënstacioneve Drenasi 2, Mitrovica 2, Prishtina 6, ndërlidhje e NS Theranda me NS Rahoveci përmes LP 110 kV të ri të ndërtuar, ndërlidhja e NS Prishtina 4 me NS Prishtina 6 përmes LP të ri, ndërlidhja e NS Mitrovica 2 me NS Vushtrria 1 dhe NS Vallaçi me dy LP të adaptuar kanë përfunduar gjatë vitit 2020, duke ndikuar në ndryshimin e rrjetit të transmetimit të KOSTT-it e të cilat ndryshime duhet të implementohen edhe në sistemin qendror SCADA/EMS.

Gjatë këtyre viteve ka pas ndryshime edhe në aspektin e organizimit të mbikëqyrjes së daljeve të nënstacioneve si 35kV ashtu edhe atyre 10 kV e të cilat i takojnë KEDS-it, ashtu që KEDS ka bërë investime në sistemin e monitorimit dhe kontrollit të këtyre daljeve sipas përgjegjësisë të caktuar që i takojnë KEDS-it, ashtu që ato dalje/fusha të pajisjeve janë larguar nga sistemet SCS(Substation Control System) të nënstacioneve 110 kV, duke ndikuar që pjesa e mbetur e nënstacioneve që është përgjegjësi e KOSTT-it të kenë pengesa në kryerjen e operimit të plote dhe të sigurte të tyre. Këto pengesa duhet të evitohen me projektet që do të realizohen përmes të projektit/nen-projekteve “Furnizim me pajisje për adoptim të SCADA/EMS dhe SCS dhe adoptim i SCS-ve” .

Nga ana tjetër në sistemin qendror SCADA/EMS të KOSTT, me largimin e këtyre fushave nga skema një polëshe e nënstacioneve përkatëse, janë krijuar mundësi që të rritet numri i pikave (tagave) të lira softuerike e nevojshme (të liruara nga KEDS) për të bërë integrimin e ndryshimeve të përshkruara më lart në sistemin qendror SCADA/EMS duke siguruar kështu që rrjeti i transmisionit që është obligim i KOSTT të operohet dhe monitorohet në tërësi nga QND/QEND.

Prandaj, propozojmë që, në vitin 2021, buxheti i mbetur nga ky projekt, respektivisht vlera prej 178,000.00 euro, të bartet për projektin “Furnizim me pajisje për adoptim të pajisjeve SCADA/EMS dhe SCS dhe si dhe adoptimi i SCS-ve, projekt ky në Planin Investiv 2018-2022.

Furnizimi me pajisje për adoptim të SCADA / EMS dhe SCS – Ky projekt është palnifikuar për periudhën 2018-2022, dhe në Planin Investiv 2018-2022 janë të lejuara 220,000.00 euro (me TVSh).

Pas incizimit të gjendjes së pajisjeve në nënstacionet e nivelit 220/kV dhe 110 kV, janë evidentuar kërkesat për blerje/ndërrim të pajisjeve, softuerëve(update dhe upgrade) dhe shërbime të domosdoshme për të siguruar funksionim e monitorimit dhe operimit të sigurt të sistemit të transmetimit, si dhe për të evituar rrezikun e humbjes së funksioneve vitale për operim.

Bazuar në gjendjen aktuale të pajisjeve, jetëgjatësinë e tejkaluar në të gjitha rastet si dhe mungesa e përkrahjes softuerike për shkak të zhvillimeve teknologjike dhe softuerike, gjatë vitit 2019/2020 janë përgatitur specifikimet teknike për adoptim të pajisjeve SCS(Substation Control System), duke përfshirë edhe disa pajisje tjera të evidentuara dhe të vlerësuara si të domosdoshme për monitorim dhe kontrolle të plote të nënstacioneve nga largësia.

Vlerësimi për realizim të këtyre kërkesave për blerje/shërbime është bërë bazuar në ofertat e fundit në projektet ku ka pas pajisje dhe shërbime të ngjashme.

Për vitin 2021 është planifikuar që të kryhen furnizime/shërbime në vlerë deri në 1,5 mil euro.

Kërkesa për rritje të buxhetit për këtë projekt, në vlerë prej 1.2 mil, bazohet në vlerën e buxhetit të tanishëm (122,250.00 euro), bartjen e buxhetit 178,000.00 euro(nga projekti “Përfshirja e nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në QND dhe QEND”), si dhe në vlerësimin se për vitin 2021 na duhet buxhet 1.5 mil euro.

Planifikimi për vitin 2021 është për adoptim të SCS-ve në nënstacionet si në vijim:

- NS Kosova A, NS Prishtina 4,
- NS Palaj, NS Rahovec, NS Skenderaj, NS Gjakova 2, NS Berivojce, NS Vitia

dhe për blerje të kompjuterëve/Workstation për disa nënstacione tjera të nivelit 110 kV.

Shqyrtimi i problemit - Pajisjet e instaluar për monitorim dhe kontrollë të nënstacioneve të theksuara si më lartë e kanë kaluar afatin standard të jetëgjatësisë prej 10 vjetësh. Të gjitha sistemet e SCADA-s në këto nënstacione janë realizuar në vitet 2008-2009 dhe ka kohë që paraqiten probleme me pajisje dhe është evidente mungesa e pjesëve rezerve dhe përkrahjes softuerike. Të këto sisteme, respektivisht pajisjet që realizojnë funksionet SCS, sistemet operative dhe aplikacionet përkatëse tanimë janë të vjetruara gjë që vështirëson/pamundëson mirëmbajtjen e mëtutjeshme të tyre duke rrezikuar se do të vjen deri të humbja e funksioneve përkatëse, respektivisht të SCADA-ve për nënstacione dhe monitorimit nga QND.

Deri më tani është mirëmbajtur hardueri, duke bërë edhe kombinime dhe modifikime të ndryshme të pajisjeve, por tani më opsionet janë shumë të limituara dhe në mungesë të pjesëve rezervë dhe pamundësisë së gjetjes në treg, është e domosdoshme të behet furnizim me harduer të ri. Ndërrimi i harduerit (serverëve dhe HMI-ve) e bën të domosdoshme edhe kalimin nga sistemi operativ Windows XP/Windows server 2003 në Windows 10 Profesional dhe Windows 2016/2019. Këto ndryshime kushtëzojnë që edhe versionet aktuale të aplikacioneve të SCADA në nënstacione të përditësohen për t’u përshtat me sistemet operative të reja.

Realizimi i këtyre projekteve, mund të përshkruhet si në vijim:

- Furnizimi me harduer dhe pajisje tjera të specifikuara për secilin nënstacion
- Furnizimi me softuer, respektivisht sisteme operative dhe aplikacione për SCADA
- Ridizajnimi i nënstacionit (NS Skenderaj, NS Rahovec, NS Palaj, NS Prishtina 4 (integrimi i NS Prishtina 7 në Prishtina 4). Ndërrimi i harduerit, sistemit operativ dhe

aplikacionit përkatës për SCADA në nënstacione dhe kushtëzon përditësimin e projektit aktual (aplikimi i ndryshimeve në nënstacione dhe përshtatja e projektit në versionin e ri të aplikacionit) për funksionim të komunikimit të SCADA, në njërin anë me pajisjet inteligjente të fushave të nënstacionit dhe në anën tjetër me SCADA/EMS në QND dhe QEND (gjë që është e domosdoshme të bëhet nga prodhuesi/ekspertët e aplikacionit).

Për të gjitha nënstacionet e cekura janë përgatit specifikimet teknike, janë në proces të finalizimit, duke specifikuar kërkesat përkatëse të përshkruara si më lartë, gjithnjë bazuar në sistemet aktuale, ndryshimet që duhet të bëhen, pajisjet tjera të domosdoshme për të kompletuar funksionimin e monitorimit dhe operimit të mirëfilltë të nënstacioneve si në aspektin lokal ashtu edhe në aspektin e monitorimit dhe kontrollit nga QND dhe QEND. Përgatitje e specifikimeve teknike për këto projekte na ka mundësuar që të bëjmë një vlerësim të përafërte të kostos financiare. Bazuar në këto vlerësime është paraqitur edhe kërkesë për rritje të buxhetit për këtë projekt.

Përmbajtja e projektit dhe përfitimet

NS Prishtina 4 dhe NS Kosova A janë të një rëndësie të veçantë sepse janë të nivelit 220/110kV me të cilat ndërlidhen shumë nënstacione tjera. Duke u bazuar në rëndësinë e këtyre nënstacioneve dhe problemet të cilat janë paraqitur kohëve të fundit me rënien nga puna të serverëve, rënie e komunikimit me QND, dhe faktin se çdo problem i paraqitur reflektohet edhe me ndikime negative për funksionim të Bllokut Rregullues AK, është me rëndësi të madhe të bëhet ndërrimi i këtyre pajisjeve.

NS Berivojca është i një rëndësie të veçantë, sepse gjendet në një pozicion ku kemi lidhje interkonektive me shtetin fqinj. Nga ky nënstacion neve na duhet të dërgojmë të dhëna edhe në bllokun AK e të cilat duhet të jenë të një saktësie të lartë, të dhëna këto të cilat tani nuk janë të sakta dhe stabile për arsyet e cekura si më lartë(Shqyrtimi i Problemit).

NS Vitia dhe NS Skenderaj gjithashtu nënstacione të cilat kanë shumë probleme në operim dhe monitorim. Në këto nënstacione disa prej pajisjeve BCU-ve(pajisje inteligjente Bay Control Unit) janë të reja dhe disa do vendosen me këtë projekt. Pjesa e fushave të nënstacionit të cilat duhet të integrohen në SCADA të NS Vitia, me pajisje të reja kontrolluese(BCU), janë dy fushat e linjave dhe fusha lidhëse. Realizimi i projektit për këto nënstacione bazohet në arsyet e cekura si më lartë(Shqyrtimi i Problemit).

NS Gjakova 2, pajisjet e grumbullimit të të dhënave (BCU të Schneider Electric) janë në gjendje të mirë, të instaluar rishtazi dhe të integruara në SCADA-en aktuale të këtij nënstacioni. Realizimi i projektit për këtë nënstacion bazohet në arsyet e cekura si më lartë(Shqyrtimi i Problemit).

Objektivat e projektit dhe përfitimet - Me realizimin e projekteve për nënstacionet e cekura duhet të evitohet mundësia e bllokimit të funksionimit të sistemit SCS në këto nënstacione, gjë që mund të ndodhë për shkak të vjetërsimit të harduerit, bllokimit të punës së aplikacionit për SCADA në këto nënstacione (korruptimit të herëpashershëm të sistemit operativ), mungesës së pjesëve rezervë etj.

Investimi për realizim të projekteve të këtyre nënstacioneve është i domosdoshëm për të mundësuar rritjen e sigurtë për funksionim të pandërprerë të monitorimit dhe kontrollit të nënstacioneve duke siguruar edhe komunikim të plotë me QND, QEND dhe me Bllokun Rregullues AK.

Te gjitha që janë theksuar si më lartë, si kërkesa për investime dhe funksionim të pandërprerë të të dhënave në kohe reale, janë detyrë e KOSTT për të plotësuar obligimet e marrëveshjeve ndërkombëtare pas anëtarësimit në ENTSO-E.

Projekti ID 039 “Licenca të Microsoft dhe migrimi i sistemit të TIK” - Ky projekt pritet të realizohet në fillim të vitit 2021.

Projekti ID 037 “Rregullimi i Dhomës së Serverëve sipas Standardeve” - Ky projekt është vlerësuar me prioritet dhe nga ana e KOSTT janë bërë të gjitha veprimet përfshirë përgatitjen e specifikimit teknik dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Vonesa në realizim është si pasojë e procedurave të prokurimit të cilat janë zhvilluar por është paraqit e nevojshme të përsëriten. Projekti tani është në fazën e vlerësimit të ofertave.

Projekti ID 057 “Përmirësimi i infrastrukturës së Sigurisë në Selinë Qendrore” - Me që Udhëzimet Administrative që rrjedhin nga Ligji Nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike dhe detajet lidhur me masat që përfshijnë identifikimin e aseteve të rëndësishme, vlerësimin e rreziqeve, si dhe identifikimin, përzgjedhjen dhe prioritizimin e kundërmasave dhe procedurave, nuk janë aprovuara gjatë vitit 2020, si dhe duke u bazuar në gjendjen e krijuar nga pandemia Covid 19, gjë që ka krijuar situata të kufizimit të pranisë së kontraktorëve në Ndërtesën e Selisë Qendrore, ky Projekt është shtyrë për vitin 2021.

Gjithashtu gjatë vitit 2019-2020 KOSTT ka planifikuar projektin e sendërtimit të dhomës së serverëve si dhe rehabilitimin e kthinave 0.4kV të cilat në aspekt të hapësirës ndërlidhen me Projektin e Përmirësimit të infrastrukturës së Sigurisë në Selinë Qendrore.

Për këto arsye vlera 200,000 Euro e këtij projekti duhet të bartet në vitin 2021 kur edhe do të bëhet realizimi i tij duke e ngritur nivelin e sigurisë në Ndërtesën e Selisë Qendrore ku është e vendosur Qendra Dispeçerike të përcaktuara si pjesë të infrastrukturës kritike, në harmoni me Ligjin në fuqi.

Projekti ID 037 “Rregullimi i Dhomës Rezerve së Serverëve - Qendra Emergjente” - Ky projekt është planifikuar që të realizohet pas realizimit të projektit “Rregullimi i Dhomës së Serverëve sipas Standardeve”, pra pas realizimit të projektit në Selinë Qendrore të KOSTT, dhe kjo ka ndikuar që ky projekt të shtyhet për vitin 2021. Realizmi i projektit në selinë qendrore të KOSTT, do të shërbejë si përfitim nga përvoja dhe përfitim nga shfrytëzimi racional i pajisjeve në dispozicion.

Projektet e Reja –

1. “Reaktori shant-variabil 100 MVar, 400 kV në NS Ferizaj 2” - Analiza e kost _benefitit

1. Hyrje

Në tri vitet e fundit vërehet rritja e nivelit të tensionit në rrjetin horizontal, kryesisht kjo ngritje vërehet në nivelin 400 kV dhe 220 kV. Në disa periudha kohore, sidomos gjatë regjimit veror të operimit të sistemit, niveli i tensioneve tejkalon vlerat nominale maksimale të përcaktuara nga Kodi i Rrjetit. Ky nivel i lartë i tensioneve krijon sforcim të madh në izolimin e pajisjeve të tensionit 400 kV duke rrezikuar rënje të rrezikshme të sistemit të zbarrave dhe në anën tjetër ndikon në reduktimin e jetës së pajisjeve dhe ngritjen e humbjeve në bërthamat e transformatorëve (humbjet në hekur). Në figurën 1 mund të shihet frekuenca e paraqitjes së mbritensioneve ($>U_{max}=420kV$) të matura në NS Peja 3. Vit pas viti vërehet që orët e operimit të rrjetit në kondita mbi-tensioni janë duke u rritur dhe janë mjaftë shqetësuese. Disa rënje të linjave dhe zbarrave janë regjistruar gjatë dy viteve të

fundit si pasojë e mbitensioneve dhe kryesisht shfaqen në zonat e ndotura dhe me lagështi të lartë. Zona rreth Termocentraleve karakterizohet me konditat e lartpërmendura.




Figura 1. Frekuenca e shfaqjes së mbitensioneve ne zbarrat 400 kV ne NS Peja 3 gjatë vitit 2019

Ky problem i shfaqur nuk mund të zgjidhet në mënyrë të izoluar vetëm nga KOSTT, pasi që është problem rajonal i shfaqur si rezultat i ndërtimit të shumë linjave 400 kV në rajon dhe atë pa kompensim të fuqisë reaktive. Në anën tjetër niveli i ngarkimit të rrjetit horizontal në rrjetin e Evropës Juglindore ka pësuar ulje si rezultat i recesionit ekonomik në rajon. Ky problem disa vite më herët është shfaqur në rrjetin horizontal të Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa gradualisht është zgjeruar edhe në pjesën e afërt me rrjetin tonë transmetues. Futja në operim e linjave të reja 400 kV ne region pa kompensim adekuat, me nivel të ulët të ngarkimit ka ndikuar që të shfaqet tepricë e fuqisë reaktive kapacitative e cila ngriti ndjeshëm nivelin e tensioneve. Në bazë të studimit regjional me titull “Regional Feasibility Study for voltage profiles improvement in the Western Balkans” është identifikuar që rrjeti regjional nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimorë (WB6) ka tepricë të fuqisë reaktive rreth 800 MVAR. Shpërndarja, apo kontributi i secilës OST në këtë tepricë të fuqisë reaktive është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 4 Tepricat e fuqisë reaktive për gjashtë OST-të e rajonit

OST	CGES	KOSTT	NOS/EL.PRENOS	MEPSO	EMS	Total
0	207	75	327	143	42	794

Sasia prej 800 MVAR është një vëllim minimal i kompensimit të fuqisë reaktive që duhet të instalohet në rajonin “WB6” për të mbajtur nivelin e tensioneve nën kufirin e sipërm të lejuar (420 kV). Vëllimi i kërkuar i kompensimit të fuqisë reaktive për gjendjen ekzistuese të sistemit, bazuar në rezultatet optimale të rrjedhës së fuqisë sipas studimit është rreth 950 MVAR, duke respektuar brezin e tensionit të synuar në 400 kV në intervalin nga 1.05 pu (420 kV) - 1.03 pu (412 kV). Ky vëllim duhet të lejojë marginën e nevojshëm të sigurisë për shërbimet e sistemit të kontrollit të tensionit.

Sipas studimit deri ne 2030 KOSTT duhet të instaloj reaktor të fuqisë reaktive në brezin nga 120MVar deri 150MVar, bazuar në të dhënat e modeleve regjionale afatgjata. Duke konsideruar pasiguritë e realizimit të këtyre planeve dhe duke pas në konsideratë që gjeneratorët e rinjë duhet të plotësojnë kushtet teknike për përkrahje të sistemit me fuqi reaktive atëherë fillimisht KOSTT do të instaloj reaktorin variabil me fuqi 100 MVar në lokacionin e rekomanduar nga studimi. Sipas informacioneve Shqipëria ka të instaluar një reaktor 120 MVar ne rrjetin 220 kV dhe se shpejti pritet të instalohet reaktori i dytë 120MVar ne NS Elbasan. Gjithashtu në dy vitet e ardhshme pritet që CGES operatori i Malit të Zi do të instaloj në NS Lastva reaktorin 250MVar, për shkak të problemeve që është duke u përballuar nënstationi konvertorik në NS Lasva e cila lidhë kabllon nënujorë me Italinë. Këto projekte do të jenë esenciale për të evituar mbtensionet kritike mbi 430 kV, ndërsa për të stabilizuar tërë rrjetin e vendeve WB6, duhet të instalohen 100 MVar ne NS Vranje (EMS), 220MVar ne NS Tuzlla dhe 120MVar ne NS Mostar (NOS/El.PRENOS) dhe 150MVar ne NS Dubrova dhe 100 MVar ne NS Oher (MEPSO).

Studimi rekomandon instalimin e reaktorëve shant-variabil (VSR) pasi që kanë avantazhe kundrejt shant-reaktorëve me fuqi fikse.

Reaktorët shant-variabil (VSR) lejojnë një kompensim të vazhdueshëm të fuqisë reaktive në brezin nga nga 20-100% të kapacitetit nominal, me aplikimin e rregullatorit të tensionit, të ngjajshëm si tek transformatorët e fuqisë. Shpejtësia e rregullimit përcaktohet nga rregullatori i tensionit dhe mund të plotësojë variacione relativisht të ngadalta të ngarkesës (sezonale, ditore ose në orë). Kontrolli i reaktorëve variabil zakonisht kryhet nga operatorët, përmes sistemit SCADA.

Përdorimi i VSR lejon që kompensimi i fuqisë reaktive të rregullohet në varësi nga ngarkesën aktuale dhe të operojë rrjetin në një mënyrë optimale, duke zvogëluar kështu humbjet e fuqisë dhe duke rritur kapacitetin e fuqisë aktive të linjave. Përfitime të tjera të rëndësishme përfshijnë:

- Kyçja e shkallëve të caktuara të kapacitetit të reaktorit variabil manifestohet me impulse me të vogla të komutimit krahasuar me reaktorët shant.
- Nëse VSR punon me në brezin e ulët të fuqisë së instaluar, humbjet dhe emetimet e zhurmës zvogëlohen,
- Duke rregulluar induktivitetin e reaktorit brenda vetë njësisë, ndërprerësit e fuqisë do të kenë më pak numër të kyçjeve dhe shkyçjeve dhe do të kenë nevojë për më pak mirëmbajtje,
- Ofrojnë fleksibilitet për tu përshtatur me ndryshimet e ardhshme të ngarkesës (në ekonomitë në zhvillim me një kërkesë në rritje të kërkesës, ku ngarkesa do të rritet me kalimin e kohës).

Duhet të theksohet se një VSR është një zgjidhje më kosto-efektive sesa dy reaktorë fiks; është më pak i kushtueshëm, kërkon më pak hapësirë për instalim, kërkon më pak pajisje (vetëm një ndërprerës) dhe lejon një rregullim më të mirë të variacioneve të ngarkesës sezonale dhe ditore.

Projekti parasheh:

- Instalimin e Shant-Reaktorit variabil, 400 kV me fuqi 100 MVar ne fushën e lirë C03 ne NS Ferizaj 2 (figura 2)
- Instalimin e fushës së reaktorit 400 kV




Figura 2. Skema njëpolare e vendosjes së reaktorit 100MVAR ne NS Ferizaj 2
Përfitimet e pritshme nga projekti:

- *Evitimi i mbitensioneve në rrjetin transmetues*
- *Përmes reduktimit të mbi-tensioneve reduktohet vjetërsimi i përsheptuar i pajisjeve të tensionit të lartë si rrjedhojë e degradimit të izolimit në pajisje*
- *Evitohen lidhjet e shkurta në zbarrat e nënstacioneve kryesore në KOSTT ku efektohen edhe gjeneratorët TC Kosova B dhe TC Kosova A*
- *Reduktohen numri i lidhjeve të shkurta në rrjetin transmetues si rrjedhojë e shpërthimit të izolimit nga mbitensionet, e më këtë edhe energjia e padërguar tek konsumatori*
- *Evitohen operimet e TC Kosova B dhe TC Kosova A në regjimin e nën-ekscitimit (absorbim i fuqisë reaktive) dhe ruhet stabiliteti i tyre.*
- *Reduktimi i efektit të Koronës dhe humbjeve të shkaktuara nga ky efekt*
- *Reduktimi i rrjedhave të fuqisë reaktive në linja dhe ngritja e kapacitetit bartës të linjave për fuqi aktive.*

Për shkak të rëndësisë së lartë projekti është konsideruar me prioritet të lartë. Projekti planifikohet të energjizohet në Q2-2022.

2. Indikatorët e benefitit (përfitimeve)

Vlerësimi i projekteve në rrjetin e transmetimit paraqet një proces kompleks i cili në vete ndërthurë lidhshmëritë në mes të të gjitha kostove të parapërcaktuara që janë të nevojshme në zhvillimin e projektit dhe benefiteve/përfitimeve të pritshme nga projekti, duke shqyrtuar ndikimet mjedisore dhe sociale si faktorë të paevitueshëm për çdo lloj projekti i cili zhvillohet në hapësirat e banueshme apo të mbrojtura.

Në figurën 3 është paraqitur struktura themelore e vlerësimit të projekteve.




Figura 3 Struktura themelore e procesit të vlerësimit të projekteve në transmision.

Gjatë procesit të vlerësimit të projekteve në bazë të metodologjisë së adaptuar të ENTSO-E ekzistojnë indikatorët e ndryshëm të klasifikuar si:

- Indikatorët e Benefitit
- Kostoja e projektit
- Ndikimet mjedisore dhe sociale
- Kapaciteti transmetues i rrjetit GTC

Indikatorët e Benefitit janë tetë dhe definohe si ne vijim:

B1. Mirëqenia socio-ekonomike(SEW) ose integrimi i tregut karakterizohet me mundësinë e projektit në zvogëlimin e ngufatjeve dhe me këtë sigurohet ngritje e kapacitetit transmetues e cila mundëson rritjen e shkëmbimeve komerciale, ashtu që tregjet e energjisë elektrike mund të tregtojnë) në mënyrë me ekonomike.

*Nëse i referohemi projektit për instalimin e reaktorit, bazuar në studimin regjional në lidhje me problematikën e mbi-tensioneve në rrjetin regjional të Evropës Juglindore, që përfshin 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor (WB6) të kryer në vitin 2020, si përfitim i kategorisë B1 njihet kontributi i reaktorëve në zvogëlimin e rrjedhave të fuqisë reaktive në linjat interkonektive dhe ngritja e NTC për transmetim të fuqisë aktive në rrjetin regjional. Në bazë të studimit Kosova përfiton rreth **0.172 M€/vit** si rezultat i rritjes së NTC-ve.*

B2. Ndryshimi në CO2 paraqet reduktimin e emetimit të CO2 në Sistemin Elektroenergjetik për shkak të projektit. Ky reduktim është rrjedhojë e ndryshimit të dispeçimit të gjeneratorëve dhe aktivizimit të potencialit të BRE-ve. Qëllimi për reduktimin e CO2 në mënyrë eksplicite paraqet një nga caqet e EU-20-20-20 dhe për këtë arsye konsiderohet si indikator i veçantë.

Nëse i referohemi studimit të kryer, si rezultat i kursimit të humbjeve dhe dispeçimit optimal të gjenerimit Kosova kursen rreth 2300 ton CO2 në vit pas instalimit të Reaktorit.

B3. Integrimi i BRE-ve, respektivisht përkrahja e integritetit të BRE-ve definohe si aftësi e sistemit elektroenergjetik që të mundësojë kyçjen e BRE-ve reja dhe aktivizimin e BRE-ve ekzistuese dhe të ardhshëm, duke zvogëluar në minimum ndërprerjet (reduktimet) e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të. Integrimi i BRE-ve paraqet një nga caqet e EU-20-20-20.

Projekti në mënyrë direkte nuk kontribuon në integrimin e BRE-ve, por instalimi i tij rritë sigurinë e operimit të BRE-ve për shkak të mirëmbajtjes së tensionit në vlerat e lejuara në pikat e kyçjes së BRE-ve.

B4. Ndryshimet në mirëqenien shoqërore, si rezultat i reduktimit të emetimit të CO₂ dhe integritetit të BRE-ve paraqet ngritjen e mirëqenies shoqërore përmjet efekteve ekonomike, të cilat identifikohen gjatë vlerësimit të indikatorit B1.Reduktimi i emetimit të CO₂ dhe integriteti i BRE-ve në sistemin elektroenergjetik për shkak të projektit pjesërisht i numërohet (atribuohet) indikatorit B1 (SEW). Reduktimi i emetimit të CO₂ dhe integriteti i BRE-ve rezulton në ndryshimin e kostove variabile të gjenerimit dhe kostove të emetimit për shkak të prodhimit të energjisë nga gjenerimi konvencional me kosto variabile jo-zero dhe me kosto të emetimit (p.sh. taksa e karbonit) duke ndikuar në ngritjen e kostove të sistemit. Megjithatë kjo mund të mos reflektoj të tërë mirëqenien shoqërore duke pas me shumë BRE në sistem, apo në koston totale shoqërore të emetimit të CO₂ (p.sh. dëmi i shkaktuar nga emetimi i një ton të CO₂ jo domosdo reflekton koston e certifikatave të emetimit që prodhuesit duhet të paguajnë). Këto efekte shtesë raportohen në këtë indikator.

B5 Ndryshimi i humbjeve në rrjet të transmetimit paraqet koston e kompensimit të humbjeve termike (humbjet e Xhaulit) në sistemin elektroenergjetik për shkak të projektit. Përndryshe paraqet një indikator të efikasitetit të energjisë së shprehur si kosto në Euro për vit.

Sipas studimit nëse marrim parasysh madhësinë proporcionale të projektit të rekomanduar në studim për KOSTT që supozohet të jetë reaktor variabil 150 MVAR dhe planit të KOSTT-it që të instaloj 100 MVAR, mund të konsiderohet që rreth 5000 MWh/vit reduktohen humbjet totale në rrjetin transmetues pas instalimit të Reaktorit variabil në NS Ferizaj 2. Në studim nuk është marrë në konsiderat reduktimi i humbjeve të Korones të cilat janë në varshmëri proporcionale me tensionin e rrjetit, çka do të thotë që reaktori duke mbajtur nivelin e tensioneve në nivelin e lejuar, redukton edhe humbjet e Korones që shfaqen kryesisht në linjat e tensionit të lartë, me theks të veçantë në linjat 400 kV dhe 220 kV.

B6 Siguria e furnizimit: Adekuacia e furnizimit të kërkesës karakterizon ndikimin e projektit në aftësinë e sistemit elektroenergjetik që të sigurojë furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike për kërkesën gjatë një periudhe të zgjatur të kohës. Efektet e ndryshimeve klimatike dhe prodhimi nga BRE-te merret në konsideratë.

Në këtë rast është konsideruar që rreth 1080MWh energji e padërguar, respektivisht e pa gjeneruar në vit si rrjedhojë e probabilitetit të lartë të humbjes së zbarrave në NS Kosova B dhe renja e dy njësive B1 dhe B2 të TC Kosova B për 2orë në vit. Zbarrat në NS Kosova B, duke operuar me mbtensione, arrijnë pikën kritike të izolimit dhe vije deri të lidhja e shkurtë e zbarrave me tokën duke shkaktuar renjën e të gjitha linjave, transformatorëve dhe gjeneratorëve të kyçur në NS Kosova B. Duke konsideruar nivelin e ndotjes dhe lagështisë së ajrit në NS Kosova B, probabiliteti është shumë i lartë që gjatë ngarkesave minimale dhe tensioneve të larta të shfaqen këto fenomene të rrezikshme për sistemin elektroenergjetik.

B7 Siguria e furnizimit: Fleksibiliteti i Sistemit: karakterizon ndikimin e projektit në kapacitetin e sistemit elektroenergjetik për të akomoduar ndryshimet e shpejta dhe të thella të kërkesës (neto) në kontekst të futjes në nivel të lartë të gjeneratorëve elektrik të pa-dispeçueshëm.

Në një mënyrë indirekte reaktori luan rol në këtë indikator, pasi që gjeneratorët lirohen nga absorbimi i fuqisë reaktive dhe ballafaqohen vetëm me prodhimin e fuqisë aktive me faktorë optimal të fuqisë.

B8 Siguria e furnizimit: Stabiliteti i Sistemit: karakterizon ndikimin e projektit në stabilitetin e sistemit që të ofroj furnizim të sigurt të energjisë elektrike sipas kriterëve teknike të definuar në Kodin e Rrjetit (Kriteri N dhe Kriteri N-1/rrjedhat e fuqisë, lidhjet e shkurta, stabiliteti tranzient, stabiliteti i tensioneve).

Ndikimi i reaktorit sipas këtij indikator është relevant nga vet fakti që redukton mundësitë e shfaqjes së lidhjeve të shkurta në sistem të shkaktuara nga mbitensionet.

Ndikimet tjera të projektit definojnë si:

S.1 Ndikimi mjedisor e paraqet ndikimin tjetër të projektit siç vlerësohet përmes studimeve preliminare, dhe synon të japë një matës të ndjeshmërisë së mjedisit në relacion me projektin.

Ndikimi mjedisor ka të bëjë me ndikimin lokal të projektit mbi natyrën dhe biodiversitetin, ashtu siç është vlerësuar përmes studimeve preliminare. Shprehet në kuptimin e sa kilometrave të linjës ajrore ose kabllorë nëntokësore/nënujore, e që mund të kalojnë përmes një zone të ndjeshme mjedisore (zona urbane, zona të mbrojtura, zona arkeologjike, parqe nacionale etj).

Projekti i reaktorit nuk ka ndikim mjedisor, trajtohet njëjtë sikurse transformatorët e fuqisë dhe do të instalohej në fushën rezervë CO3 në NS Ferizaj 2.

S.2 Ndikimi social paraqet ndikimin e projektit në popullsinë lokale që preket (ndikohet) nga projekti siç është vlerësuar përmes studimeve preliminare, dhe synon të japë një matës të ndjeshmërisë sociale në relacion me projektin.

Reaktori nuk ka ndikim social pasi që instalohej në hapësirën e brendshme të NS Ferizaj 2.

S.3 Ndikimet tjera paraqesin indikatorin i cili përfshinë të gjitha ndikimet e mundshme të projektit

Këta tre indikator i referohen ndikimeve të mbetura, pas zbatimit të masave për minimizimin e ndikimeve. Për këtë arsye ndikimet të cilat minimizohen për shkak të masave shtesë nuk duhet të paraqiten në këtë kategori.

Ndikime tjera konsiderohen efektet e dëmshme të operimit të pajisjeve të tensionit të lartë me mbitensione, duke shkaktuar degradimin e vazhdueshëm të nivelit të izolimit të transformatorëve të fuqisë, gjeneratorëve, transformatorëve matës rrymor të tensionit dhe rrymës dhe pajisjeve tjera të kyçura në rrjetin transmetues.

Kostoja e projektit definojnë si:

C1. Kostoja Kapitale (CAPEX). Ky indikator tregon vlerën e investimeve për realizimin e projektit, i cili përmban elemente siç janë shpenzimet për marrjen e lejeve, për realizimin e studimeve të fisibilitetit, për shpronësim, për parcelën e ndërtimit, për parapërgatitje, për dizajn, për pajisjet dhe materialet dhe për instalim apo demontim. Kostoja Kapitale e projektit vlerësohen në bazë të krahasimeve të kostove për projektet e ngjashme të realizuara dhe nga vlerësimi në bazë të parametrave nga informacionet publike për kostot e projekteve të ngjashme. CAPEX shprehet në Euro.

Kostoja e totale e Projektit të Reaktorit variabil 100 MVar së bashku me fushën përkatëse 400 kV është vlerësuar të jetë 2.7 M€

C1. Kostoja Operative (OPEX). Këto shpenzime bazohen në kostot e operimit dhe mirëmbajtjes së projektit. Kostoja Operative e të gjitha projekteve duhet të jepet në bazë të vlerave aktuale të kostove dhe të shpërndahet për vite e shprehur si Euro për vit.

Kostoja vjetore operative për reaktorin 100 MVar është vlerësuar të jetë 10800 €/vit bazuar ne studimin e kryer.

Kapaciteti Transmetues i Rrjetit “Grid Transfer Capability” (GTC) definohet si:

GTC paraqet aftësinë e rrjetit për të bartur energjinë elektrike nga një zonë në zonën tjetër. Ndërlidhja e dy zonave paraqet fytyrën e ngushtë në sistemin elektroenergjetik ku aftësia bartëse është e pamjaftueshme për të akomoduar rrjedhat e mundshme të fuqisë (që rezultojnë nga skenarët). Për pjesën e brendshme të rrjetit, GTC mund të ndikohet nga linjat e reja si dhe nga transformatorët shtesë të instaluar në nënstacionet ekzistuese apo në nënstacionet e reja. Në linjat e reja interkonektive GTC mbi 500 MW paraqet në fakt ndikimin e konsiderueshëm regional të linjës së re, ashtu siç definohet nga ENTSO-E. Kryesisht linjat 400 kV mund të ndikojnë në ngritjen e GTC për 500 MW.

Projekti në mënyrë indirekte ndikon në rritjen e NTC-ve të linjave interkonektive të identifikuara në B1

3. Rezultatet e KBA-së

Në vijim janë dhënë rezultatet e KBA-së, ku shihet që shkalla e kthimit është e kënaqshme 12.22% ndërsa poentomi 20.5, nga 33 maksimalja (figura 4 dhe 5).

Emri i Projektit	Instalimi i reaktorit variabil 100 MVAr ne NS Ferizaj 2													
	Viti	2021	2022	2023	2024	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	
Indikatorët	Njesia													Totali ne 12 vite
B1. Siguria e furnizimit	MWh	0	0	1080	1080	1080	1080	1080	1080	1080	1080	1080	1080	11880
	€ -	€ -	€ -	€ 48,600	€ 48,600	€ 48,600	€ 48,600	€ 48,600	€ 48,600	€ 48,600	€ 48,600	€ 48,600	€ 48,600	€ 534,600
B2. Mirëqenia socio-ekonomike	MWh	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	€ -	€ -	€ -	€ 172,000	€ 172,000	€ 172,000	€ 172,000	€ 172,000	€ 172,000	€ 172,000	€ 172,000	€ 172,000	€ 172,000	€ 1,892,000
B3. Integrimi i BRE-ve	MW or MWh	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
B4. Ndryshimi ne humbje	MWh	0	0	5000	5000	5000	5000	5000	5000	5000	5000	5000	5000	55000
	€ -	€ -	€ -	€ 225,000	€ 225,000	€ 225,000	€ 225,000	€ 225,000	€ 225,000	€ 225,000	€ 225,000	€ 225,000	€ 225,000	€ 2,475,000
B5. Ndryshimi ne CO2	kton	0	0	2.3	2.3	2.3	2.3	2.3	2.3	2.3	2.3	2.3	2.3	25
	€ -	€ -	€ -	€ 16,100	€ 16,100	€ 16,100	€ 16,100	€ 16,100	€ 16,100	€ 16,100	€ 16,100	€ 16,100	€ 16,100	€ 177,100
B6. Elasticiteti teknik/siguria e sistemit	score (N-1)	0	0	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	NA
B7. Fleksibiliteti teknik	score (N-1)	0	0	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	NA
C1.Kostoja totale e projektit		€ 540,000	€ 1,350,000	€ 810,000	€ -	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 2,786,400
Kostoja investuese	€ -	€ 540,000	€ 1,350,000	€ 810,000	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ 2,700,000
Kostot variabile/ mirembajtja	€ -	€ -	€ -	€ -		€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 86,400
S.1. Ndikimi mjedisor	km	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
S.2.Ndikimi Social	km	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Kapaciteti i Transmetues i Rrjetit (GTC)	MVA or MW													NA
Benefitet totale	€ -	€ -	€ -	€ 461,700	€ 461,700	€ 461,700	€ 461,700	€ 461,700	€ 461,700	€ 461,700	€ 461,700	€ 461,700	€ 461,700	€ 5,078,700
Kostot totale	€ -	€ 540,000	€ 1,350,000	€ 810,000	€ -	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 10,800	€ 2,786,400
Net Benefit/kosto	€ -	-€ 540,000	-€ 1,350,000	-€ 348,300	€ 461,700	€ 450,900	€ 450,900	€ 450,900	€ 450,900	€ 450,900	€ 450,900	€ 450,900	€ 450,900	€ 2,292,300
Norma e zbritjës	4%													
Faktori i zbritjës		1.00	0.96	0.92	0.89	0.82	0.79	0.76	0.73	0.70	0.68	0.65	0.62	
Indeksi i vitit		0	1	2	3	5	6	7	8	9	10	11	12	
Shpenzimet e diskontuara	€	540,000	€ 1,298,077	€ 748,891	€ -	€ 8,877	€ 8,535	€ 8,207	€ 7,891	€ 7,588	€ 7,296	€ 7,015	€ 6,746	
Benifitet e diskontuara	€	-	€ -	€ 426,868	€ 410,450	€ 379,484	€ 364,888	€ 350,854	€ 337,360	€ 324,384	€ 311,908	€ 299,912	€ 288,376	
NET Benifit/Kosto te diskontuara	-€	540,000	-€ 1,298,077	-€ 322,023	€ 410,450	€ 370,607	€ 356,353	€ 342,647	€ 329,468	€ 316,796	€ 304,612	€ 292,896	€ 281,631	
Komulative	-€	540,000	-€ 1,838,077	-€ 2,160,100	-€ 1,749,650	-€ 984,380	-€ 628,027	-€ 285,380	€ 44,088	€ 360,884	€ 665,496	€ 958,392	€ 1,240,023	
NPV														€ 1,240,022.86
Shkalla e kthimit														12.22%

Tabela-5 Llogaritja e NPV-së dhe shkalla e kthimit te projektit Reaktori 100 MVAr ne NS Ferizaj 2




Figura 4. Vlerësimi i poenave të projektit në bazë të indikatorëve kryesor të KBA-së




Figura 5. Diagrami i NPV-së për projektin Reaktor i variabil 100 MVar 2. Projekti

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 30 nga 35</i>

” Integrimi në platformën ENTSO-e-VP platform(RGCE function)-Qasja VP Platforma-Qasja MVC, STA/OPC” - Pas implementimit të Marrëveshjes së kyçjes KOSTT_ENTSO-e, KOSTT që nga 14 Dhjetor 2020 ka filluar operimin si Zonë rregulluese në kuadër të bllokut Shqipëri-Kosovë, i njohur si blloku rregullues AK.

Operimi si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues AK përfshinë kryesisht aktivitete që ndërlidhen me bashkëpunimin e OST-ve fqinje, rajonale e më gjerë, me qëllim të operimit të sigurve të sistemit. Bashkëpunimi i ngushtë i OST-ve bazohet në parimin e respektimit të rregullave dhe kodeve teknike Evropiane. Për shkak të fillimit të operimit në kuadër të Bllokut, në KOSTT duhet të arrihen këto objektiva:

- Ngritja e kapacitetit të stafit të Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut për ti kryer punët e reja të cilat tani më ndërlidhen pe operimin e KOSTT si Zonë rregulluese në kuadër të bllokut AK dhe implementimin e Marrëveshjeve operative me ENTSO-E dhe OST fqinje, të cilat ndërlidhen me:
 - Analiza e punës së sistemit një ditë para dhe gjatë ditës;
 - Nominimi i programit ndërkufitar dhe programeve të palëve tregtare një ditë para në formë të autorizuar përmes softuerëve dhe platformave adekuate;
 - Krijimi i modelit referent të rrjetit për SEE të Kosovës për qëllim të llogaritjeve të parametrave të sigurisë së operimit, veprimi adekuat në rrethana emergjente, përpunimi i planit të ri mbrojtës, alokimi i kapacitetit dhe llogaritja e kongjestioneve;
 - Dërgimi i të dhënave të nevojshme përmes platformave të cilat KOSTT duhet ti ketë, për në platformën e transparencës në ENTSO-E, etj;

ENTSO-E ka krijuar grupin prej ekspertëve (PG TSO KOSTT) për monitorimin e KOSTT-it në plotësimin e kërkesave të cilat dalin nga SOGL (System Operation Guideline) dhe SAFA (The Synchronous Area Framework Agreement).

Kërkesat janë kryesisht teknike të cilat ndërlidhen me:

- sigurinë e operimit të sistemit,
- shkëmbimet tregtare ndërkufitare dhe plotësimi i kriterëve nga pakëti i tretë i energjisë të Komisionit Evropian.
- Sigurimi i shërbimeve ndihmëse, etj.

3. Projekti “Softuer për detektimin e sulmeve kibernetike” - Që nga viti 2014 KOSTT ka në shfrytëzim antivirusin F-Secure dhe që nga ajo kohë nuk kemi pas probleme sa i përket çështjes së sigurisë së sistemit të TIK në aspektin e infektimit nga viruset apo programet tjera malicioze. Në dekadat e fundit teknologjia është integruar gati në çdo vend pune. Tani jetojmë në një botë më të përparuar teknologjike por megjithëse e dobishme na ekspozon ndaj rrezikut të shtuar nga krimet kibernetike përmes Internetit e sidomos viteve të fundit në masë të madhe është shtuar rreziku.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 31 nga 35</i>

Gjatë vitit 2019 sulmet kibernetike janë rritur për 53% bazuar në Raportin global të rrezikut të të dhënave VARONIS 2019 (<https://www.varonis.com/2019-data-risk-report/>).

Po ashtu edhe sipas raportit të Agjensionit Evropian për Siguri Kibernetike (ENISA) (<https://www.enisa.europa.eu/publications/enisa-threat-landscape-2020-data-breach>) është rritë për 54% numri i përgjithshëm i shkeljeve nga mesi i viti 2019 krahasuar me vitin 2018.

Sulmet e synuara të sigurisë kibernetike mund të jenë të vështira për t'u analizuar dhe për t'u përgjigjur ndaj tyre si dhe bëhet një problem jashtëzakonisht i madh i cili bartë me vete kosto shumë të lartë në rastet e dëmtimit të të dhënave. Vetëm faza e rehabilitimit pas sulmit kibernetik mund të zgjasë me muaj. Sulmet pa skedar (fileless) nuk mund të identifikohen nga mbrojtja tradicionale me antivirus dhe sulmet e shënjestruara shpesh kalojnë pa u vërejtur me muaj të tërë apo edhe vite.

Përveç mbrojtjes nga viruset, F-Secure ka zhvilluar edhe softuer tjerë për mbrojtjen nga sulmet kibernetike. Një prej tyre është softueri 'F-Secure Rapid Detection & Response'. Me implementimin e 'F-Secure Rapid Detection & Response' mund të fitojmë dukshmëri kontekstuale në sigurinë e sistemit të TIK, mund të identifikojmë kërcënimet dhe mund të ndalojmë sulmet para se ato të ndodhin në dëmtimin e të dhënave të ndjeshme, konfidenciale ose mbrojtjen e tyre nga ekspozimi ndaj palëve të paautorizuara si një krim kibernetik

Përfitimet nga përdorimi i 'F-Secure Rapid Detection & Response' janë:

- Monitoron në mënyrë të vazhdueshme rrjetin dhe zbulon në mënyrë të detajuar sulmet kibernetike.
- Ndihmon dhe ofron përgjigje të saktë dhe udhëzime të integruara kur ka sulme apo rreziqe kibernetike si dhe asistencë profesionale nga F-Secure
- Vizualizon sulmet në kontekst më të gjerë me të gjitha çështjet përkatëse, zbulimet si dhe gjetjet në tërësi
- Mundëson identifikimin e kërcënimeve të avancuara në mënyrë automatike në bazë të niveleve të rrezikut
- Ndalon sulmet shpejt me udhëzime të integruara ose të automatizuara
- Ofron zgjidhje të çështjeve të vështira si dhe analiza të incidenteve sipas kërkesës
- Përmes konzolës ofron mundësi të menaxhimit më të lehtë
- Dukshmëri e plotë në të gjithë mjedisin TIK

Me instalimin e 'F-Secure Rapid Detection & Response' sektori i TIK nuk do të jetë i angazhuar që në çdo moment të jetë prezent kur ka rreziqe të tilla prandaj e automatizon mënyrën e monitorimit, gjetjet si dhe raportin në detaje kur shfaqen rreziqe të tilla 24 orë në ditë.

Përfundimisht besojmë se me instalimin e një softueri me renome botërore do të rritej standardi i përgjithshëm i sigurisë si dhe do të ketë siguri maksimale ndaj sulmeve kibernetike dhe atyre të ngjashme.

Kostoja e këtij softueri duke u bazuar në infrastrukturën aktuale të KOSTT është 35,000 EUR

4. Realizimi i infrastrukturës së transmissiionit për kalim nga 10kV në 20kV sipas kërkesave të KEDS - Si rezultat i punimeve të cilat janë duke u realizuara nga KEDS në Prishtinë me qëllim të konvertimit të nivelit të tensionit në qytetin e Prishtinës nga niveli 10kV në nivelin 20kV që

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 32 nga 35</i>

ka efekte të rritjes së performancës së rrjetit të tyre, zvogëlimin e humbjeve teknike, KOSTT ka marrë obligime në përkrahje të këtij projekti përmes aktiviteteve të nevojshme për te ndihmuar këtë proces. Ne kuadër të kësaj KOSTT duhet të furnizohet me kthina te reja 20 kV modulare, shkarkues, izolator, elemente lidhëse etj.

5. Furnizimi me Makinë për Ekipin e MRNS –ky projekt është i nevojshëm për projektet qe janë duke u zhvilluar "Konvertimi i tensionit nga niveli 10kV ne 20kV nga ana e KEDS" për NS Prishtina 2, NS Prishtina 3 dhe NS Prishtina 6 etj. Gjithashtu është i nevojshëm për intervenimet eventuale në nënstacione të KOSTT. Makina përdoret për lakim, shpim dhe prerje të zbarrave të bakrit të nivelit 10kV(20kV).

6. Furnizimi me Vegla dhe Mjete Pune për ekipin e MRLP - Linjat ajrore transmetuese paraqesin ndër asetet kryesore të KOSTT-it, e si të tilla mirëmbajtja e rregullt e tyre është parakusht për funksionimin normal të tyre. Punët e përditshme në linjat ajrore 400, 220 dhe 110KV, implikojnë edhe nevojat për furnizim me pajisjet dhe veglat për punë që janë të nevojshme dhe të domosdoshme për mirëmbajtjen e tyre, duke siguruar në këtë mënyrë funksionimin e rregullt të tyre.

Me qellim te sigurimit te cilësisë se mirëmbajtjes për vitin buxhetor 2021 është parapare furnizimi me vegla dhe mjete pune për mirëmbajtjen e :

- Linjave transmetuese ajrore 400/220/110 kV si dhe
- Linjat nëntokësore kabllorike 110 kV

Në bazë të këtyre nevojave dhe kërkesave duhet të furnizohemi me

- vegla dhe pajisje pune,
- përfshirë furnizimin e completeve te veglave për punëtorë
- pajisje personale për pune stafin i cili punon ne lartësi,
- si dhe vegla për punime ne kablllo nëntokësore
- Veglat e punës do të përdoren nga punëtorët të cilët do të jenë të përgatitur dhe të autorizuar për kryerjen e këtyre punëve në linjat kabllorë transmetuese.

7. Projekti “Renovim i pjesës së lokaleve në Kurriz-mbi plato” - Ky projekt është projekt i ri krahasuar me Planin investiv 2020-2021. Në bazë të analizave të cilat do të prezantohen në vazhdim është konsideruar si investim i nevojshëm për arsyet si ne vijim:

- domosdoshmëria e renovimit te këtyre hapësirave duke konsideruar gjendjen e krijuar në mungesë të investimeve për me shume se 30 vite
- ngritja e sigurisë së punëtorëve duke evituar qasjen ekzistuese për hyrje në zyra (zyrat ekzistuese). Evitimi i qasjes ekzistuese ne zyra do te behet me realizim te qasjes se hyrjes sipas projektit për këtë investim
- krijimit të hapësirave të reja për punë, qe vlerësohet shume e nevojshme për te mbuluar kërkesat e KOSTT

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 33 nga 35</i>

Prandaj, paraqesim kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të këtij projekti në planin Investiv 2018-2021.

Shqyrtimi i problemit - Në zyrat ekzistuese të KOSTT në Kurriz qasja bëhet nga shkallët e jashtme të cilat janë të pambuluara. Mbulimi eventual i tyre do të bënte errësimin e hapësirave të punës, prandaj nderimi i hyrjes duke e pozicionuar të njëjtën nga platoja ashtu si është dhënë në skemën e mëposhtme do ti sillte benefite të shumta shfrytëzimit të këtyre zyrave fillimisht duke e ngritur sigurinë e qasjes në objekt si dhe rregullimin e disa hapësirave të cilat nuk janë rinovuar nga viti 1985.


Arsyet e benefiteve në rastin e renovimit të lokaleve mbi plato:

1. ngritja e sigurisë dhe kualitet të zyrave ekzistuese duke ndërruar pozitën e hyrjes në zyrë
2. krijimi i hapësirave të reja për punë
3. pamja nga jashtë e objektit (pjesës së lokaleve që janë në pronësi të KOSTT-it) është mjaft e keqe, dhe kjo ka ndikim në imazh të kompanisë.(foto 1 dhe 2-krahasimi)
4. ngritja e sigurisë(instalimi i sistemeve të alarmit kundër zjarrit)

Përmbajtja e përgjithshme e projektit

Në kuadër të këtij projekti përfshihet:

- Punime demoluese;
- Mbyllja dhe mbështjellja e fasadës;
- Punimi i dyerve, dritareve, dyshemesë, elektrikes, etj.



Baza e zyrave në KURRIZ(hapësirat e reja janë të hijezuara)

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 35</i>



Dukja ekzistuese



Propozimi i unifikimit të fasadës

Objektivat e projektit dhe përfitimet - Objektiva primare e realizimit të këtij projekti është krijimi i qasjes së sigurve në zyrë si dhe krijimi i hapësirave të reja për punë.

Plani i implementimit të projektit - Ky projekt planifikohet të realizohet në vitin 2021.

KBA e Projektit - Lokalet mbi plato do të duhej të rinovohen në bazë të projektit ideorë ku do të fitojmë 2X6 vende të reja të punës, ndërsa njeri të shërbejë si hyrje e re për zyrat e KOSTT me ç'rast do të rritej edhe kualiteti i zyrave ekzistuese.

Qiraja nga lokalet: - Qiraja e inkasuar për 3 vite nga të gjitha lokalet në Kurriz rreth 36.000,00 Euro.

Gjatë përpilimit të projekt propozimit është përcaktuar vlera e përafërt e renovimit të këtyre hapësirave rreth 35.000,00Euro.

Me që më lartë është dhënë vlera e inkasuar për tri vite nga qiraja nga këto lokale si dhe nevoja e domosdoshmërisë për realizim të tij mund të përfundohet se ka arsyeshmëri të plotë për propozimin e dhënë në këtë dokument.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 35 nga 35</i>

6.0 PËRMBLEDHJE

Viti 2020 ka qenë vit i sukseseve të mëdha në KOSTT. Nënshkrimi i marrëveshjes së re të kyçjes KOSTT-ENTSO-E dhe fillimi i operimit si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues AK ishte arritje historike për kompaninë tonë dhe Kosovën.

Pas më shumë se katër vite që nga përfundimi i ndërtimit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri në të dy anët e kufirit, sot përfundimisht linja e njohur si “Autostrada Energjetike Kosovë-Shqipëri” komercialisht është në funksion.

Kjo vjen si rezultat i fillimit të operimit të KOSTT si Zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë.

Vënia në operim e linjës interkonektive të tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri do të ketë impakt pozitiv në optimizimin e dy sistemeve, rritjen e kapaciteteve transmetuese, rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve elektroenergjetike të Kosovës, Shqipërisë dhe regjionit si dhe do të ndikojë në zhvillimin e tregut të të dy vendeve si dhe tregut rajonal të energjisë elektrike.

Të gjitha këto arritje kanë ndikim direkt në shërbimet cilësore dhe mirëqenien e konsumatorit, si nga aspekti i sigurisë së furnizimit ashtu edhe nga aspekti financiar.

Duke marrë parasysh dinamikën e zhvillimeve në sistemin e transmisionit sipas kërkesave nga ENTSO-E është me rëndësi vitale përkrahja e kërkesave për projektet e reja si dhe ndryshimet në ato aktuale si dhe kërkesat për shpenzime operative.

Andaj, besojmë se kërkesat e KOSTT do të aprovohen dhe ndryshimet do të përfshihen në të hyrat e lejuara maksimale.

- Fundi i Dokumentit -